



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 40/2022 regjistër (JR)
Datë 14.09.2022

Nr. 19 i vendimit
Datë 11.03.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 11.03.2025, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Kapedani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 533, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 62 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Kapedani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave:

2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit Enkeleda Kapedani,¹ në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procedurave të kryera nga grupi i punës, fillimisht dërgoi raportin² pa përgjigjen e një prej autoriteteve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ të Shtetit, raport në të cilin konstatoi përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda N. Kapedani. Pas kërkesës së Komisionit nr. {***} prot., datë 21.05.2021, nga DSIK-ja përcillet raporti i përditësuar,³ sipas të cilit disponohet një e dhënë mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Në përfundim të raportit konkludohet se: *“Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Enkeleda N. Kapedani, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi, si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ, që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”*.

2.3. KLGj-ja, në zbatim të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 01.03.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të pasurisë së subjektit Enkeleda Kapedani, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda N. Kapedani”, deklasifikuar plotësisht nga Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZh), me vendimin nr. {***}, datë 30.04.2021.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.05.2021, përcillet raporti i deklasifikuar pjesërisht nga KDZh-ja me vendimin nr. {***}, datë 11.06.2021.

burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ka përcjellë Komisionit një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Kapedani.

3. Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse, si më sipër, bazuar në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit: **(a)** ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të rremë për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016; **(b)** nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016; **(c)** nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, me vendimin nr. 533, datë 18.05.2022, bazuar në nenin 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Enkeleda Kapedani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”*.
5. Këtë vendimmarrje, Komisioni e ka mbështetur në konkluzionet e arritura për secilin kriter rivlerësimi, si vijon:

5.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- i. *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë vetting, në përputhje me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.*
- ii. *Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi i saj kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.*
- iii. *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën vetting, në kuptim të parashikimeve të germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëjetuesi i saj ka kryer veprime fiktive në lidhje me automjetin tip kamion.*
- iv. *Subjekti ka tentuar të paraqesë në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e bashkëjetuesit të saj me z. L. L., në lidhje me huan dhe transaksionet ekonomike, që lidhen me shitblerjen e automjetit tip kamion, duke deklaruar të dhëna të pasakta, si dhe duke depozituar dokumentacion fiktiv në lidhje me blerjen në vlerën 950.000 lekë të kamionit, shitjes së tij në vlerën 32.000 euro dhe dhënies së huas, në vlerën 28.000 euro, z. L. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar, qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje, besimin e publikut të një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sigurtë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të rremë për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat sipas pikës 3, të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*

5.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

“Duke marrë në konsideratë rezultatet [...], si dhe gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, rezulton se bashkëjetuesi i subjektit ka pasur kontakt me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parashikimeve të germave “b” dhe “c” të nenit 38/4, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisioni

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.11.2018, “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani”.

konstaton gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, duke marrë në konsideratë faktin e ndërthurjes së interesave personale të saj dhe bashkëjetuesit të saj (shitblerja e kamionit dhe huaja) me një person të dënuar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin kontrollit të figurës sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 dhe se do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj saj”.

5.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe vlerësimin e çështjes në tërësi:

“[...] konstatoi gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, mbi bazën e një analize të detajuar [...], që mori në konsideratë: (i) paraqitjen nga subjekti në mënyrë të pasaktë të marrëdhënies së bashkëjetuesit të saj me z. L., në lidhje me huan dhe transaksionet ekonomike, që lidhen me shitblerjen e automjetit tip kamion, duke deklaruar të dhëna të pasakta, si dhe duke depozituar dokumentacion fiktiv në lidhje me blerjen në vlerën 950.000 lekë të kamionit, shitjes së tij në vlerën 32.000 euro dhe dhënies së huas, në vlerën 28.000 euro, z. L.; (ii) sjelljen e saj në procesin e rivlerësimit për sa i përket marrëdhënies së bashkëjetuesit të saj me z. L.; (iii) ndërthurjen e interesave personale të saj dhe të bashkëjetuesit me një person të dënuar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar, parë nga këndvështrimi i publikut; (iv) kryerjen e videove në ambientet e punës, shoqëruar me lëvizje dhe sjellje provokuese në një sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati; si dhe (v) depozitimin e deklaratave noteriale të denoncuesve, të cilët deklarojnë se nuk i kanë bërë ata denoncimet.

Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër për kriteret e rivlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Komisionit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji”.

III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Kapedani, ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 533, datë 18.05.2022, të Komisionit, me pretendimet se ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe nuk ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e saj në detyrë. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton vendimin e Komisionit, si në kuadër të procedurës së rivlerësimit të ndjekur në Komision, ashtu edhe sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes për të tria kriteret e rivlerësimit. Këtë vendim objekt ankimi, subjekti e konsideron jo vetëm paragjykes dhe të paracaktuar, por edhe haptazi të padrejtë, të pabazuar në ligj dhe në prova, të marrë tërësisht në kundërshtim me provat e administruara, në transformim të gjendjes reale të fakteve dhe të akteve.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Kapedani, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

8. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, për shqyrtimin e vendimit nr. 533, datë 18.05.2022, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, të zhvilluar në datën 11.03.2025.
10. Trupi gjykues i Kolegjit, fillimisht, mori në analizë shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor të kryer pranë Komisionit, duke vlerësuar si vijon:

10.1. Në ankim ngrihet pretendimi se është i vetmi subjekt rivlerësimi, për të cilin është riçelur 2 (dy) herë hetimi administrativ dhe janë zhvilluar 3 (tre) seanca dëgjimore, është shkruar një vendim voluminoz⁵, ndonëse nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur asnjë pasuri, asnjë kontakt të papërshtatshëm dhe ka pasur vetëm 9 (nëntë) muaj punë⁶ deri në plotësimin e deklaratave në kuadër të procesit të rivlerësimit. Hetimi administrativ, sipas subjektit, ka qenë i veshur me urrejtje dhe paragjykim, me qëllimin e vetëm shkarkimin e saj nga detyra.

10.1.1. Trupi gjykues, pasi analizoi aktet e fashikullit të Komisionit në këtë drejtim, i gjen këto pretendime të pabazuara. Për sa i përket seancave dëgjimore, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Enkeleda Kapedani janë zhvilluar tri seanca dëgjimore, më datat 15.11.2021, 19.01.2022 dhe

⁵ Vendim i përbërë në tërësi nga 145 (njëqind e dyzet e pesë) faqe.

⁶ Subjekti i rivlerësimit pretendon se i është nënshtruar procesit të rivlerësimit vetëm për një periudhë 9 (nëntë) - mujore, pra 3 (tre) muaj në vitin 2015 dhe 6 (gjashtë) muaj në vitin 2016 (13.06.2016, rikthimi pas lejes së lindjes) deri në janar 2017, kur ka dorëzuar deklaratën e pasurisë vetting.

16.05.2022, dhe vendimi është shpallur më datë 18.05.2022. Komisioni, pas seancës së parë dëgjimore të datës 15.11.2021, për shkak të denoncimeve të reja të mbërritura, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ. Një ditë pas seancës së dytë dëgjimore, të datës 19.01.2022, është depozituar nga vëzhguesi ndërkombëtar një “Gjetje dhe mendim”, për të cilin Komisioni, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur të riçelë hetimin administrativ.

10.1.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se qëndrimi i Komisionit ka qenë paragjykes dhe i veshur me gjuhë urrejtjeje, nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, të datës 15.11.2021, trupi gjykues konstaton se seanca është zhvilluar e rregullt dhe ndërhyrjet e komisioneres kryesuese kanë qenë në kuadër të mundësimit të përkthimit për vëzhguesin ndërkombëtar apo në respektim të efektivitetit dhe ekonomisë gjyqësore, për të shmangur përsëritjen e informacioneve që tashmë ishin relatuar dhe gjendeshin në dosjen gjyqësore. Në rubrikën atribuuar pyetjeve të trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar, pyetjet e ngritura nuk konsiderohen në tejkalim të qëllimit për të cilin zhvillohet seanca dëgjimore, konkretisht qartësimin e të gjitha çështjeve të relatuara dhe shpjeguara, për saktësimin e qëndrimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, të cilat mund të kenë krijuar paqartësi për trupin gjykues dhe kanë qenë të nevojshme për t’u sqaruar më tej. Pra, paqartësitë i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Përpos sa më sipër, edhe vetë subjekti i rivlerësimit, në përfundim të kësaj seance, është shprehur se: *“Procesi ka qenë i rregullt. Vlerësoj trupën për objektivitetin dhe vërtetësinë dhe korrektesën për zhvillimin e këtij procesi [...]”*.

10.1.3. Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 19.01.2022, trupi gjykues i Komisionit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në seancën pararendëse, ku për efekt të ekonomisë gjyqësore i është kërkuar subjektit që të përqendrohet te dokumentacioni dhe çështja. Gjatë kësaj seance, komisionerja kryesuese ka sjellë në vëmendje një formë të shprehuri të subjektit të rivlerësimit, që karakterizon në fakt qëndrimin e saj në sqarimet/shpjegimet e dhëna dhe që manifeston, nëpërmjet fjalëve, shkronjave kapitale e shenjave të pikësimit të përdorura, një indinjatë/revoltë të subjektit të rivlerësimit. Nëpërmjet pyetjes drejtuar subjektit, komisionerja kryesuese ka dashur të sqarojë se kujt i drejtohet ky qëndrim, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka sqaruar dhe theksuar se nuk i adresohet Komisionit, por atyre që e kanë sulmuar pambarimisht e në mënyrë të vazhdueshme në 8 (tetë) muajt e fundit, pra vetëm të tretëve, denoncuesve.

10.1.4. Në sqarimet e datës 23.03.2022, për rezultatet e hetimit shtesë pas riçeljes së dytë të hetimit lidhur me “Gjetjen dhe mendimin” e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se është ndjerë e sulmuar dhe e paragjykuar në këtë proces administrativ, së pari lidhur me gatishmërinë e Komisionit për të riçelur hetimin dy herë, një herë për denoncimet nga publiku, pa luajtur një rol proaktiv në verifikimin e autorëve dhe vërtetësisë në to, së dyti ka pretenduar se ka qenë në pozita paragjykesë lidhur me trajtimin dhe mënyrën e drejtimit të pyetjeve gjatë seancës dëgjimore të datës 19.01.2022. Depozitimi i “Gjetjes” nga vëzhguesi ndërkombëtar vetëm të nesërmen e kësaj seance, ngre dyshime, sipas saj, për dijeninë e Komisionit mbi këtë “Gjetje” që më parë. Pyetjet e ngritura nga vëzhguesi ndërkombëtar tregojnë se ai ka qenë në dijeni përpara depozitimit të “Gjetjes” mbi të dhënat në të dhe, në shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ka dashur ta vërë subjektin në pozita të disfavorshme në mbrojtje, duke insistuar me pyetje që subjekti të pranonte një marrëdhënie të ngushtë shoqërore të bashkëjetuesit me z. L. L. Në vijim, në sqarimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vëzhguesi ndërkombëtar ka paragjykuar çështjen e saj në seancë dëgjimore, duke i drejtuar pyetje, pa u njohur paraprakisht me aktet në dosjen gjyqësore të saj.

10.1.5. Marrë shkas nga këto pretendime, në seancën dëgjimore të datës 16.05.2022, komisionerja kryesuese i ka bërë me dije subjektit të rivlerësimit që trupi gjykues nuk kishte dijeni për “Gjetjen” e vëzhguesit ndërkombëtar në seancën e datës 19.01.2022. Në vijim, subjekti i rivlerësimit është shprehur se ka qenë emocionale në mbrojtjen drejtuar Komisionit, edhe pse në thelb ngarkesa e saj emocionale nuk lidhet drejtpërdrejt me trupin gjykues të Komisionit, por me situatat që është dashur të kalojë, pa lidhje me trupin gjykues apo me procesin dhe që janë fakte botërisht të njohura.

10.1.6. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se riçelja e hetimit administrativ nuk tregon qasje negative apo paragjykim nga ana e Komisionit, por domosdoshmëri në kushtet e denoncimeve të depozituara, të cilave ligji u ka atribuuar një rol kyç në këtë proces, si dhe “Gjetjes dhe mendimit”, të ONM-së, të cilit ligji nr. 84/2016, në nenin 49, pikat 10 dhe 11 të tij, i ka dhënë përkatësisht vlerën e provës apo të një përfundimi të dhënë për një rrethanë konkrete, duke parashikuar detyrimin e organeve të rivlerësimit për të arsyetuar vendimmarrjen në rast refuzimi. Nga ana tjetër, nën dritën e këtyre rrethanave dhe përcaktimeve ligjore, çelja e hetimit administrativ është bërë për t’i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet zbatimit të parimit të kontradiktoritetit, për të paraqitur prova dhe argumente lidhur me denoncimet dhe me “Gjetjen dhe mendimin”. Ngritja e pyetjeve në seancë dëgjimore, në kuadër të qartësimit të situatave në analizë, nuk duhet konsideruar paragjykim, kur nga subjekti janë administruar parashtrime voluminoze, të detajuara dhe kur janë zhvilluar tri seanca dëgjimore, me një kohëzgjatje në total rreth 7 (shtatë) orësh, e aq më pak të perceptohet si sulm. Nga leximi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues nuk konstaton asnjë notë paragjykimi apo gjuhë urrejtjeje, duke e gjetur pretendimin e subjektit të pabazuar. Përkundrazi, vetë specifikat e procesit ndaj subjektit, riçelja dy herë e hetimit dhe zhvillimi i seancave, nuk mbështesin pretendimin e subjektit për një vendim të paracaktuar. Sa i përket arsyetimit dhe konkluzionit të Komisionit lidhur me themelin e çështjes, Kolegji, në vijim të këtij vendimi, do të vlerësojë bazueshmërinë e tij.

10.1.7. Ndërsa për sa i përket pretendimit të subjektit, se i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke pasur vetëm nëntë muaj punë në detyrën e gjyqtarës, pra tre muaj në vitin 2015 dhe gjashtë muaj në vitin 2016 (13.06.2016, rikthimi pas lejes së lindjes), trupi gjykues e vlerëson pa relevancë këtë element në kuadër të procesit të rivlerësimit, për sa kohë nga interpretimi sistematik i dispozitave të ligjeve të paketës së reformës në drejtësi, vlerësohet se standardi i vendosur në kuadër të kësaj reforme, në lidhje me verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës, sipas të njëjtave standarde të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm për kontrollin dhe deklarimin e tyre, i nënshtrohen edhe kandidatët për t’u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe të diplomuarit prej kësaj shkolle para emërimit të tyre si magjistratë gjyqtarë/prokurorë.

10.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë asnjë provë apo shpjegim të saj dhe se vendimi pasqyron të njëjtat konkluzione të raportit mbi rezultatet e hetimit administrativ. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, pasi në këtë vendim gjejnë vend jo vetëm shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, por edhe provat e paraqitura prej saj në mbështetje të tyre, që në disa raste, kryesisht atyre të trajtuara në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, ato janë gjetur bindëse nga Komisioni.

10.3. Ndryshe nga procedura e ndjekur për subjektet e tjerë të rivlerësimit, në rastin konkret Komisioni ka përfshirë në hetim administrativ edhe pasuritë e krijuara pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, në tejkalim të qëllimit të ligjit nr. 84/2016, duke synuar të verifikojë pasuri të tjera të pajustificuara të subjektit/bashkëjetuesit, me qëllim ngarkimin e barrës së provës për të rënduar

pozitën e saj, pa evidentuar shprehimisht konstatimet nga hetimi i kryer lidhur me to. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton se, në kuadër të hetimit administrativ kryesisht, në zbatim të nenit 50, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni është vënë në dijeni nga institucionet shtetërore⁷, për dy pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit/bashkëjetuesit, konkretisht automjet tip “Volkswagen”, blerë më 18.02.2017, në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe apartament banimi me sipërfaqe 117.2 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në bashkëpronësi me bashkëjetuesin, përfutur nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme me kusht kreditimi, të datës 19.06.2019. Për këto dy pasuri, si në rezultatet e hetimit administrativ dhe në vendim, Komisioni nuk ka ngritur asnjë dyshim mbi krijimin dhe ligjshmërinë e tyre. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

11. Në përputhje me nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj, më datë 27.02.2025, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, si dhe akte bashkëlidhur, konkretisht: (i) shkresë nr. {***} prot., datë 20.02.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, së bashku me vendimin nr. {***}, datë 02.04.2024, të kësaj gjykate, që i përket çështjes me të pandehur M. L. alias S. Ç.; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 26.02.2024, të Shkollës së Magjistraturës, mbi klasifikimin e kandidatëve për magistrat në profilin gjyqtar, që kanë mbaruar vitin e tretë në këtë shkollë, për vitin 2013 – 2014. Në kushtet kur këto akte shkresore nuk plotësonin kriteret e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për të gëzuar statusin e provave të reja bashkëlidhur ankimit, si dhe nisur nga faktet që subjekti i rivlerësimit synon të provojë përmes tyre, trupi gjykues arriti në konkluzionin se, nën dritën e parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, ato konsiderohen të panevojshme për zgjidhjen në themel të çështjes dhe, për pasojë, vendosi të mos i administrojë në cilësinë e provës.
12. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk gjendet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që do të legjitimonte gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe, për rrjedhojë, vijoi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

B/1 - Për veprimet juridike lidhur me mjetin tip kamion “Iveco” dhe huan

13. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit/bashkëjetuesi i saj: (a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 3.219.154 lekë, për t’i dhënë huan z. L. L., si dhe për të mbuluar shpenzimet e tjera në vitin 2016; (b) ka kryer deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, në lidhje me këtë hua, pasi në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar se është dhënë në vitin 2017, ndërsa gjatë hetimit ka deklaruar se është dhënë në vitin 2016; (c) ka kryer veprime fiktive në lidhje me automjetin tip kamion, si dhe ka kryer deklarin të rremë. Për pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë, të paplotë, të rremë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas

⁷ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.01.2020, si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.02.2020.

pikës 5, të nenit 61 të këtij ligji, pasi çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijuan bindjen për vlerën reale të shitjes së kamionit.

14. Në lidhje me marrëdhënien e krijuar mes z. L. dhe bashkëjetuesit të subjektit, për sa i përket veprimeve ekonomike me automjetin tip kamion dhe dhënies së huas, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit,⁸ Komisioni ka krijuar bindjen se gjendet në kushtet e një marrëdhënieje fiktive, të parashikuar nga neni 92 i Kodit Civil, pasi, pavarësisht se palët janë të lira të përcaktojnë çmimet e shitjes dhe se nuk ka çmime reference për shitblerje automjesh, vlera e shitjes së kamionit është jashtë logjikës ekonomike dhe ka pasur për qëllim të justifikojë me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro, z. L., duke u krijuar bindja për një skemë pastrimi parash.
15. Në çështjen objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerësoi të shqyrtojë fillimisht konkluzionet e Komisionit lidhur me veprimet fiktive dhe deklarin e rremë, nën dritën e analizimit të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, se konkluzioni i Komisionit, që veprimet e kryera mes bashkëjetuesit dhe z. L. janë veprime, të cilat nuk përputhen me logjikën ekonomike, është tërësisht i pabazuar dhe se nga kronologjia e veprimeve, shpjegimeve, provave të paraqitura nga subjekti dhe atyre të hetuara nga Komisioni, provohet plotësisht fakti që veprimet e kryera nga bashkëjetuesi i subjektit nuk janë fiktive, nuk kanë pasur asnjë qëllim për pastrimin e parave, e aq më pak të ndodhen në kushtet e deklarin të rremë, koncepte këto të paanalizuara nga Komisioni në vendim.

15.1. Në këtë drejtim, subjekti ka kundërshtuar arsyetimin e Komisionit: (i) duke e konsideruar atë paragjykes dhe të pabazuar lidhur me: -- rrethanat që kanë diktuar veprimet e ndërmarra nga bashkëjetuesi dhe L. L.; -- gjendjen ekonomike shumë të mirë të shitësit, pa analizuar historikun e shoqërisë së tij tregtare, ecurinë e aktivitetit në terma të fitimit, marrëdhëniet juridike, rrethanat jetësore të administratorit apo detyrimet e tij ndaj të tretëve. Fitimi i realizuar nga shoqëria për vitet 2015 – 2016, nuk tregon *a priori* se administratori i saj nuk ka pasur probleme financiare, të cilat nuk mund t'i mbulonte me fitimin e realizuar, duke u detyruar kështu të shesë pasuri nga aktivi i shoqërisë për mbulimin e këtyre problemeve; -- marrjen e një kredie bankare nga huamarrësi për mbulimin e problemeve të mundshme financiare, në kushtet kur financimi me kredi nuk varet nga vullneti i tij, por nga ai i institucioneve bankare, në plotësim të kushteve të kërkuara. (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi, për sa kohë nuk kishte detyrimin të ishte në dijeni për shkaqet që L. L. vendosi ta shesë mjetin me të njëjtin çmim me të cilin e kishte blerë, dhe në situatën kur bashkëjetuesi nuk ishte i detyruar të refuzonte çmimin me të cilin po i shitej mjeti. (iii) Komisioni dështoi të provojë fiktivitetin⁹ apo qëllimin e vërtetë të palëve, veprimin juridik të fshehur dhe përfitimin e paligjshëm nga këto veprime fiktive, pasi nuk ka pasur një të tillë dhe aq më pak, nuk provohet ndonjë qëllim tjetër i fshehur pas kontratës së huas. (iv) Komisioni ka gabuar, kur përcakton se mjete të tilla mund të blihen minimalisht 19.000 euro dhe maksimalisht 35.000 euro, duke i dhënë qëllimisht vlerë ligjore printimeve nga disa portale dhe duke zhvlerësuar atë të faturave tatimore të shitjes, të cilat janë dokumente shkresore me fuqi të plotë provuese, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile. (v) Referencat në jurisprudencën e Kolegjit¹⁰, për marrëdhënie fiktive, të veprimeve ekonomike mes bashkëjetuesit dhe z. L., janë jorelevante dhe nuk lidhen me rastin konkret, dhe konkluzioni se vlera e shitjes së kamionit është jashtë logjikës ekonomike, me qëllim për të

⁸ Vendimi nr. 3 (JR), datë 23.02.2022, vendimi nr. 10 (JR), datë 19.11.2018 dhe vendimi nr. 23 (JR), datë 23.09.2019, të cilat kanë pasur qëllim shmangien e detyrimit tatimor apo regjistrimin në ZVRPP.

⁹ Shih vendimin nr. 14, datë 21.01.2015, prg. 13 – 15, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

¹⁰ Vendim nr. 3 (JR), datë 23.02.2022, vendimi nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, dhe vendimi nr. 23 (JR), datë 23.09.2019, të cilat kanë pasur si qëllim shmangien e detyrimit tatimor apo regjistrimin në ZVRPP.

justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro, z. L., duke krijuar bindjen për një skemë pastrimi parash, është alogjik dhe në kundërshtim me provat e administruara gjatë hetimit administrativ. (vi) Komisioni është kontradiktor në konkluzionet e tij, sa i përket fiktivitetit të çmimit, duke mos përcaktuar/analizuar pse çmimi i blerjes/shitjes ishte fiktiv dhe pse shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk ishin të besueshme. (vii) Komisioni, bazuar në parimin e drejtësisë, paanshmërisë dhe objektivitetit, duhet të kishte hetuar edhe lidhur me destinacionin e parave pas kthimit të huas, investimet e bëra, shlyerjen e ndonjë detyrimi, mbulimin e ndonjë shpenzimi të nevojshëm të familjes, për të konkluduar lidhur me dyshimet për fiktivitet, e ndërthurur kjo me dyshimin për pastrimin e parave.

16. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton këtë situatë faktike e ligjore:

16.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron se, në datën e dorëzimit të deklaratës, më 29.01.2017, pasuria *cash* prej 1.634.000 lekësh,¹¹ të cilën ia kishin dhuruar prindërit pasi kishin shitur një pjesë të tokës të përfutur nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, në Golem i Vogël, Lushnjë, është pakësuar në 600.000 lekë, për shkak se vlera prej 1.000.000 lekësh ka shërbyer si burim për blerjen e kamionit në emër të bashkëjetuesit, L. Q., dhe pjesa tjetër është shpenzuar.

Po në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëjetuesi deklaron (pjesë takuese 100%), gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë, përfutur nga shitja e një mjeti e llojit kamion, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.10.2016, i cili ishte blerë me kontratën e blerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., më datë 29.04.2016. Çmimi i shitjes së kamionit është 32.000 euro, nga të cilat janë gjendje *cash* vetëm 400.000 lekë, ndërsa shuma prej 28.000 eurosh i është dhënë, nëpërmjet kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2017 dhe aneks kontrate nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2017, L. L., me afat kthimi 6 (gjashtë) - mujor, pa interes. Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka bërë dhe në deklaratën periodike vjetore 2016, të dorëzuar dy muaj pas asaj *vetting*, më datë 28.03.2017.

16.2. Në raportin mbi kontrollin e deklaratës së pasurisë *vetting*, ILDKPKI-ja ka konstatuar vlerë të dyshimtë të shitjes së këtij mjeti në datën 13.10.2016, në shumën 32.000 euro, ndërkohë që më datë 29.04.2016 e kishte blerë 950.000 lekë, duke e konsideruar deklarin të rremë. Transaksioni është kryer jashtë sistemit bankar. Në deklaratën periodike vjetore 2016, subjekti ka deklaruar veprime që i përkasin vitit 2017, konkretisht huadhënien, e cila ka ndikuar në gjendjen *cash* të mbetur. Sipas ILDKPKI-së në këtë raport, kontrata e huas konfirmohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, por subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për shumën e deklaruar të dhënë hua, 28.000 euro, pasi çmimi i shitjes që ka shërbyer për huadhënie, është jashtë logjikës ekonomike të tregut.

16.3. Në analizë të dokumentacionit të administruar në fashikullin gjyqësor, origjina dhe kronologjia e veprimeve juridike lidhur me mjetin dhe huadhënien rezultojnë si vijon:

16.3.1. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të

¹¹ Nëpërmjet kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2011, N., K., I. dhe Enkeleda Kapedani, si bashkëpronarë të familjes bujqësore, i shesin F. M., tokën arë me sipërfaqe 3800 m,² në Golem i Vogël, Lushnjë, kundrejt çmimit 1.634.000 lekë, shumë e likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale, përpara përpilimit të kësaj kontrate.

Transportit Rrugor¹² (në vijim “DPSHTRr”), mjeti tip kamion “Iveco Magirus”, vit prodhimi 2004, fillimisht rezulton të jetë blerë në Itali, më datë 29.01.2016, nga K. E., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerën 6.000 euro, dhe për të cilin janë paguar detyrimet doganore në vlerën 177.364 lekë. Më pas, në datën 13.04.2016, përmes “Faturë tatimore shitje” nr. {***}, ky mjet i shitet shoqërisë “{***}” ShPK Tiranë, me përfaqësues L. L., në vlerën 1.100.000 lekë.

16.3.2. Rreth dy javë pas blerjes, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2016, shoqëria “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga administratori L. L., ia shet këtë mjet blerësit L. Q., kundrejt çmimit 950.000 lekë, të shlyer njëherësh jashtë zyrës noteriale. Mjeti rezulton i regjistruar në emër të bashkëjetuesit për periudhën 27.05.2016 – 13.10.2016. Pas rreth gjashtë muajsh nga data e blerjes, më datë 13.10.2016, mjeti i shitet blerësit A. V., në shumën 32.000 euro, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale, i cili gjithashtu e shet më datë 13.04.2017, në vlerën 30.000 euro, te subjekti “A. V.”, personi fizik, me NIPT {***}¹³.

16.3.3. Nëpërmjet kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2017, L. Q. i huazon L. L. shumën 28.000 euro, për një afat njëvjeçar, 17.01.2017 – 17.01.2018, me interes 100.000 lekë/muaj, pa garanci hipotekore. Referuar kontratës së huas, palët deklarojnë se dorëzimi i vlerës së huas është bërë jashtë zyrës noteriale. Nëpërmjet, aneks kontrate nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2017, pra vetëm pas 9 (nëntë) ditëve,¹⁴ palët dakordësojnë disa ndryshime të kontratës së huas, më konkretisht duke përcaktuar afatin e kthimit të huas për një periudhë 6 (gjashtë) - mujore, si dhe duke mos parashikuar interes.

16.4. Pavarësisht përcaktimeve kontraktore, nga analizimi i deklaratave periodike vjetore rezulton që shlyerja e huas të jetë deklaruar si vijon: (i) në deklaratën periodike vjetore 2017, huaja deklarohet të jetë shlyer, 8.000 euro gjatë vitit 2017, kthyer dorazi nga huamarrësi, dhe për shumën e mbetur prej 20.000 eurosh, bashkëjetuesi deklaron se verbalisht është rënë dakord të shlyhet deri në korrik të vitit 2018; (ii) në deklaratën periodike vjetore 2018, bashkëjetuesi deklaron shlyerjen tërësore të huas nga huamarrësi L. L., sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.07.2018.

16.5. Në deklaratën noteriale të sipërcituar, të deklaruesve L. L. dhe L. Q., L. L. deklaron se, në muajin nëntor 2016, i ka marrë hua L. Q. shumën prej 28.000 eurosh, me kontratë huaje verbale, pa afat dhe pa interes. Kjo kontratë është formalizuar me shkrim në janar të vitit 2017, duke ndryshuar dhe disa nga kushtet e saj, konkretisht duke e bërë një kontratë me afat 1 (një)-vjeçar, me interes. Sa i përket interesit, deklaruesi shprehet se nga noterja në kontratë ishte shënuar vlera 100.000 lekë të reja në muaj, ndërkohë që kishin rënë dakord që interesi do të ishte 100.000 lekë të vjetra apo 10.000 lekë të reja në muaj. Ditën e nënshkrimit të kontratës nuk e kishin kuptuar që bëhej fjalë për interesin me vlerë 100.000 lekë të reja. Me të konstatuar këtë fakt u paraqitën personalisht në zyrë noteriale dhe, meqë e kthyen në kontratë pa interes, ranë dakord që të shkurtohej afati i shlyerjes së huas nga një vit, në gjashtë muaj. Deklaruesi L. L. shprehet se huaja nuk u arrit të shlyhet tërësisht në datën 17.07.2017, për shkak të pamundësisë së tij ekonomike, duke shlyer deri në këtë datë 8.000 euro, ndërsa për diferencën prej 20.000 eurosh u ra dakord: *të shlyhet kontrata e huas për 1 vit, deri në muajin korrik të vitit 2018, pa interes, për shkak të marrëdhënies së mirëbesimit (marrëdhënie e ngushtë familjare dhe miqësore) që ekziston midis nesh.* Ditën e kësaj deklarate, më 24.07.2018, L. L. deklaron para noteres t’i ketë kthyer, jashtë zyrës noteriale, L. Q., shumën prej 20.000 euro, duke

¹² Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.01.2020.

¹³ Me fushë veprimtarie: Ndërtime civile, rrugore, industriale, gërmime dheu etj., me vend të ushtrimit të aktivitetit, {***}.

¹⁴ Komisioni, gabimisht, në vendim i referohet një periudhe 3 muaj.

e shlyer tërësisht detyrimin ndaj tij dhe duke mos pasur më asnjë detyrim monetar në të ardhmen. Z. L. Q. deklaroi nga ana e tij, se të gjitha deklaratimet e bëra nga z. L. janë të vërteta dhe se detyrimi është shlyer tërësisht në këtë datë.

16.6. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të datës 26.03.2021, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me shitjen e mjetit kamion, brenda një periudhe të shkurtër kohore, në një çmim më të lartë se ai i blerjes. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga bashkëjetuesi, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK operon në fushën e ndërtimit dhe pjesë të veprimtarisë së saj ka edhe import-eksportin e automjeteve të të gjitha llojeve të tonazheve. Në muajin mars 2016, administratori i shoqërisë është vënë në dijeni të një mjeti tip kamion me çmim të volitshëm, prej 1.100.000 lekësh, të shoqërisë “{***}” ShPK, të cilin pasi e blen, vendos që ta shesë pas një periudhe të shkurtër, me një çmim të përafërt me atë të blerjes. Bashkëjetuesi, pasi ishte vënë në dijeni të këtij okazioni, vendosi ta blinte këtë mjet. Çmimi 950.000 lekë është i përafërt me atë të shpenzuar nga shoqëria “{***}” ShPK për blerjen e këtij mjeti. Në vijim, në muajin tetor 2016, ky kamion është shitur nga bashkëjetuesi në shumën prej 32.000 eurosh. Nëse çmimi i ulët i blerjes dhe çmimi i lartë i shitjes do të kishin qenë fiktivë, atëherë, në vlerësim të subjektit, nuk do të qëndronte logjika e sqarimeve se ky mjet është shitur nga shoqëria “{***}” ShPK me çmim të përafërt me atë me të cilin është blerë dhe se çmimi i shitjes nuk lë vend për fiktivitet, për sa kohë të ardhurat nga shitja e këtij mjeti nuk kanë shërbyer për blerjen e ndonjë pasurie, por thjesht janë konsumuar ndër vite. Në vazhdim të këtij sqarimi, me përgjigjet shtesë të datës 06.05.2021, subjekti i rivlerësimit ka vënë theksin në faktin se kontratat janë mjet më i përhapur juridik në qarkullimin civil të një ekonomie tregu dhe një burim i rëndësishëm i detyrimeve dhe, si të tilla, në teorinë juridike ato përkufizohen si pëlqim i vullnetit midis palëve për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie të caktuar juridike. Pra, lidhja e një kontrate bazohet në lirinë kontraktore dhe autonominë e vullnetit të palëve kontraktuese. Në rastin konkret, vetë palët kontraktuese të përfshira në shitblerjen e kamionit në fjalë kanë shprehur lirisht vullnetin e tyre lidhur me përmbajtjen dhe kushtet e kontratave të lidhura prej tyre, dhe në asnjë moment këto kushte, përfshirë edhe çmimin, nuk kanë ardhur në kundërshtim me ndonjë kufizim ligjor.

16.7. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për konstatimin se: *“Duket i dyshimtë transaksioni i shitjes së mjetit. Një kamion i blerë 950.000 lekë në prill 2016 dhe shitur 32.000 euro në tetor 2016, është jashtë logjikës ekonomike”*. Në prapësimet gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar si vijon:

16.7.1. Ndryshe nga shitja e pasurive të paluajtshme, për të cilat legjislacioni në fuqi parashikon çmime reference, për pasuritë e luajtshme nuk ka një kufizim të tillë. Sipas sqarimeve që u ka dhënë z. L. L., çmimi i ulët i blerjes së mjetit, nga shoqëria “{***}” ShPK, vinte për shkak të problemeve të saj financiare. Për të njëjtat arsye, po për shkak të problemeve financiare në familje dhe në biznes, i ndodhur përpara nevojës për likuiditet në kushtet kur shoqëritë e vogla veprojnë nëpërmjet *kleringut* dhe shkëmbimit mall me mall, bëri që L. L. ta shiste me urgjencë këtë mjet te bashkëjetuesi i subjektit. Duke qenë se kishte njohje të mëparshme me të, ra dakord për t’ia shitur mjetin sipas çmimit të përcaktuar. Në kushtet kur në atë periudhë bashkëjetuesi nuk ishte në marrëdhënie pune, e duke qenë se nuk kishte kursime të tij, subjekti i rivlerësimit i kishte dhuruar shumën në vlerën e çmimit të blerjes së kamionit, me qëllim që ai të krijonte ndonjë punë për të kontribuar në familje.

16.7.2. Për të provuar problemet ekonomike të shitësit L. L., subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision një situacion të gjendjes financiare të shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator dhe ortak

të vetëm z. L. L. Sipas subjektit ishin pikërisht problemet financiare që u bënë shkak i marrjes prej tij të huas 28.000 euro nga bashkëjetuesi, mosshlyerjes së saj në afatin e caktuar, si dhe i financimit me kredi në vlerën 12.000.000 lekë, në datën 11.05.2018,¹⁵ për kthimin plotësisht të huas. Në vijim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në jetën e përditshme, për arsye objektive (ekonomike, familjare, emigrimi, shëndetësore etj.), personat detyrohen të shesin mjetet e tyre me çmim të ulët në raport me vlerën reale që ato kanë, ndonjëherë dhe më të ulët se ai i blerjes, por kjo nuk nënkupton se ai mjet nuk vlen më shumë dhe nuk mund të shitet kundrejt një çmimi më të lartë në të ardhmen, në tregun e lirë.

16.7.3. Duke risjellë në vëmendje argumentet në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron se në rastin konkret, si çmimi i blerjes, ashtu edhe i shitjes tregojnë që fiktiviteti mungon. Fakti që nuk është krijuar asnjë pasuri me të ardhurat e fituara nga shitja e mjetit, nuk është bërë asnjë investim, nuk është shlyer asnjë prej detyrimeve që kanë pasur ndaj kredive bankare apo ndaj të tretëve tregon, sipas subjektit, se nuk ka ekzistuar asnjë qëllim i tillë, dhe nuk kishte arsye të bënin një shitje me çmim fiktiv. Referuar nenit 92 të Kodit Civil janë të pavlefshme veprimet juridike që bëhen me marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar). Fiktiviteti bëhet për të mbuluar pasojat e vërteta të veprimit juridik, me qëllim që një fakt të vërtetë e të paligjshëm ta kamuflojë si veprim të ligjshëm, ndërkohë që në rastin konkret nuk ka ekzistuar, si dhe mungon ana subjektive për të bërë ndonjë deklaram fiktiv, për sa kohë nuk vjen asnjë përfitim prej tij.

16.7.4. Në vijim të këtij argumenti, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se çmimi i blerjes dhe i shitjes së mjetit është real dhe i vërtetë, për sa kohë nuk ka asnjë *indicie* apo provë që të ketë pasur ndonjë qëllim të fshehtë përfitimi të paligjshëm. Për pasojë, sipas subjektit të rivlerësimit nuk qëndron as konstatimi i ILDKPKI-së, se bashkëjetuesi ka kryer deklaram të rremë lidhur me këtë pasuri, pasi fshehja e pasurisë dhe deklarimi i rremë bëhen për të fshehur pasuritë e padeklaruara dhe/ose pasuritë e deklaruara, të cilat janë të fituara nga burime të paligjshme e të pajustificuara, dhe nuk do të kishte sens logjik e juridik që të bëhet deklaram i rremë për ato që janë fituar në mënyrë dhe me burime të ligjshme.

16.7.5. Për të provuar se çmimet e shitjes së mjeteve të punës tip kamion në qarkullimin civil nuk janë fikse, por variojnë nga më të ulëtat deri tek më të lartat, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision disa kontrata shitje/fatura tatimore shitje¹⁶, të kryera për mjete të ngjashme, në të cilat vlerat variojnë nga 11.000 euro në 4.300.000 lekë, si dhe disa printime,¹⁷ nga portale të ndryshme në internet, të cilat reklamojnë shitjen e mjeteve të tipit kamion.

16.7.6. Në vijim të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se të gjitha transaksionet mes bashkëjetuesit dhe z. L. L. janë kryer me para në dorë, duke qenë se veprimi juridik

¹⁵ Konfirmim bankar nr. {***} prot., datë 12.04.2021, të lëshuar nga OTP Bank ShA, në të cilin vërtetohet se z. L. L. dhe znj. A. L. janë klientë të kësaj banke dhe janë financuar me një kredi në masën 12.000.000 lekë.

¹⁶ Katër fatura tatimore shitje të automjeteve të llojit kamion "Iveco": -- "Faturë tatimore shitje" nr. {***}, datë 05.09.2013, për shitjen e dy mjeteve kamion "Iveco", secili në vlerën 4.300.000 lekë; -- "Faturë tatimore shitje" nr. {***}, datë 21.04.2021, mjeti tip "Iveco", vit prodhimi 2006, në vlerën 26.000 euro; -- "Faturë tatimore shitje" nr. {***}, datë 22.10.2021, për shitjen e një mjeti tip kamion "Iveco", në vlerën 24.000 euro; -- "Faturë tatimore shitje" nr. {***}, datë 22.10.2021, për shitjen e një mjeti tip kamion "Astra", në vlerën 11.000 euro. Kontratë shitje nr. {***}/*** rep./kol., datë 13.03.2015, për shitjen e kamionit "Scania", vit prodhimi 2001, nga shoqëria "{***}" ShPK te blerësi Sh. Q., me një vlerë prej 1.500.000 lekësh. Akt shitje datë 01.11.2019, për mjetin tip kamion "Iveco", vit prodhimi 2008, me vlerë 12.000 euro, nënshkruar mes subjektit "{***}" ShPK dhe blerësit "F. Q.", personit fizik.

¹⁷ Më datë 26.07.2015, kamion "Iveco", vit prodhimi 2006, në vlerën 35.000 euro; Kamion "MAN", vit prodhimi 2003, në vlerën 35.000 euro; postuar më datë 14.02.2013; Kamion "Scania", vit prodhimi 2000, vlera 25.000 euro; Kamion "Mercedes", vlera 22.000 euro; Kamion "Actros", në vlerën 53.000 euro.

i shitjes së mjetit apo i dhënies/kthimit të huas janë kryer midis dy individëve që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare, për pasojë nuk ekziston detyrimi ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar. Ky detyrim ekziston vetëm për veprimet ndërmjet subjekteve tregtare¹⁸. Të njëjtin argument, subjekti i rivlerësimit e përsërit dhe ndaj konkluzionit të Komisionit, që në lidhje me këtë marrëdhënie mban në konsideratë edhe faktin e kryerjes së veprimeve në *cash* dhe pa asnjë dokument, deri në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*.

16.7.7. Si argument tjetër shtesë, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti përmend pasurinë vetjake, të cilën e risjell dhe në ankim, me pretendimin se ajo dhe partneri janë në marrëdhënie bashkëjetese, dhe çdo pasuri e fituar prej secilit gjatë bashkëjetesës është pasuri e veçantë e secilit. Nëse bashkëjetesa përfundon, pasuritë e fituara në mënyrë të veçantë nga secili gjatë bashkëjetesës nuk i nënshtrohen pjesëtimit gjyqësor,¹⁹ si në rastin e pasurisë së fituar gjatë martesës. Marrëdhënia pasurore e subjektit të rivlerësimit me bashkëjetuesin i nënshtrohet regjimit pasuror të “pasurive të ndara”, për rrjedhojë çdo gjë që përfiton bashkëjetuesi nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, aq më tepër në rastet kur kjo e fundit nuk përfiton prej asaj pasurie, qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën²⁰ e tij. Ligji nuk e ngarkon subjektin e rivlerësimit me barrë prove për burimin e ligjshëm të pasurisë së fituar nga bashkëjetuesi apo bashkëshorti aktual për një pasuri të blerë gjatë kohës së bashkëjetesës, në rast se subjekti i rivlerësimit nuk ka interes pasuror në atë pasuri. Të ardhurat nga shitja e kamionit janë deklaruar pasuri në pjesën takuese 100% në pronësi të tij, duke vepruar financiarisht në autonomi të plotë.

16.8. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk e ka gjetur të bazuar pretendimin e subjektit mbi vështirësinë financiare të z. L., në kushte kur ai ka arritur të marrë një kredi në vlerën 12.000.000 lekë në vitin 2018, dhe nga dokumentacioni i administruar, si dhe referuar pasqyrave financiare të vitit 2016, të aksesuara nga ekstrakti historik në Qendrën Kombëtare të Biznesit (në vijim “QKB”), nuk ka rezultuar që shoqëria e zotëruar prej tij të ketë pasur probleme financiare, pasi qarkullimi vjetor i aktivitetit të kësaj shoqërie për vitin 2015 ka qenë 36.979.225 lekë dhe fitimi pas tatimit 1.535.497 lekë, ndërsa për vitin 2016, qarkullimi vjetor ka qenë 29.717.339 lekë dhe fitimi pas tatimit 2.656.795 lekë.

16.9. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se Komisioni ka paragjykuar gjendjen ekonomike të shoqërisë së z. L., kur i është referuar fitimit të realizuar në vitet 2015 dhe 2016, pa analizuar historikun e shoqërisë, trendin e fitimit të saj, marrëdhëniet juridike dhe detyrimet ndaj të tretëve. Po kështu, sipas subjektit nuk janë identifikuar dhe as analizuar kushtet dhe rrethanat jetësore të administratorit të shoqërisë, detyrimet e tij familjare, mënyra e jetesës, shpenzimet apo detyrimet ndaj të tretëve. Realizimi i fitimit të shoqërisë për vitet 2015 – 2016, sipas subjektit nuk tregon se administratori i saj nuk ka pasur probleme financiare, të cilat nuk mund t’i mbulonte me fitimin e realizuar, duke e detyruar të shesë pasuri nga aktivi i shoqërisë për mbulimin e këtyre problemeve. Bazuar në të dhënat e QKB-së, më datë 21.12.2018, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK ka paraqitur kërkesë për pushimin e përkohshëm të aktivitetit, me argumentin se nuk ka aftësi paguese për të përballuar fluksin e shpenzimeve mujore, duke kaluar me status “pezulluar”. Administratori i

¹⁸ Shih vendimin nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit, që i përket subjektit E. I., “Komisioni konstaton se veprimi juridik i shitjes së mjetit është kryer midis dy individëve që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare, për pasojë nuk ekziston detyrimi ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar. Ky detyrim ekziston vetëm për veprimet ndërmjet subjekteve tregtare midis tyre”.

¹⁹ Shih nenet 74, 163 dhe 164 të Kodit të Familjes.

²⁰ Shih vendimin nr. 15/2021 (JR), paragrafi 23.7, të Kolegjit.

shoqërisë “{***}” ShPK, L. L., është administrator i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, e cila, bazuar në të dhënat e aksesueshme të QKB-së, rezulton me humbje në vitet 2014 – 2017, ndërsa në vitin 2018 ka realizuar një fitim në vlera minimale, duke vërtetuar kështu problemet financiare të shoqërisë.

16.10. Në analizë të këtyre pretendimeve dhe referuar dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paqartësi sa i takon raportit individ/shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Raporti i tyre nuk duhet konfunduar, pasi si në aspektin juridik, ashtu edhe në atë ekonomik, individit dhe shoqëria tregtare janë dy subjekte të ndryshme me personalitet juridik më vete dhe me pasuri e detyrime të ndara. Në rastin objekt shqyrtimi, bashkëjetuesi i subjektit, kontratën e shitjes së mjetit kamion e ka nënshkruar me shoqërinë “{***}” ShPK, ndërsa kontratën e huas me individin L. L. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të lidhë çmimin e ulët të shitjes së mjetit, prej 950.000 lekësh, në prill 2016, dhe dhënien e huas në nëntor të po këtij viti, me situatën financiare të z. L. L., në familje dhe në biznes.

Në këto kushte, sa i përket aktivitetit tregtar, si rezultat i kërkimit nga burime të hapura, në të dhëna të aksesueshme të QKB-së, L. L. rezulton ortak i vetëm dhe administrator i tri shoqërive tregtare: (i) “{***}” ShPK, me NIPT {***}, datë regjistrimi 07.07.2005; (ii) “{***}” ShPK, me NIPT {***}, datë regjistrimi 19.11.2012 dhe kapital 8.013.000 lekë, dhe (iii) “{***}” ShPK, me NIPT {***}, datë regjistrimi 20.09.2016. Ndonëse shoqëria “{***}” ShPK rezulton me humbje për vitet 2014 – 2017, dy shoqëritë e tjera, konkretisht shoqëria “{***}” ShPK²¹ dhe shoqëria “{***}” ShPK²², rezultojnë me fitim. Në këto kushte, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, *se shoqëria po kalonte probleme financiare, të cilat vinin në ngritje, kryesisht në fillim të vitit 2016, kur është lidhur kontrata e shitjes midis L. L. dhe bashkëjetuesit*, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk qëndrojnë. Pa relevancë konsiderohet dhe dokumenti i lëshuar nga administratori dhe pronari i shoqërisë “{***}” ShPK²³, z. L. L., i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, pasi nga ky dokument nuk mund të gjykohej apo të vlerësohej situata financiare e huamarrësit L. L., si individ apo shoqëri, ndërkohë që operon edhe me dy aktivitete të tjera ekonomike.

16.11. Në parashtrimet e paraqitura në Komision, gjatë seancës së datës 16.05.2022, por edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se fakti që z. L. L. ka pasur probleme ekonomike del në pah edhe nga të dhënat e dosjes penale mbi konfliktin e tij me z. G. K., për prishjen e pazarit në shitjen e një kamioni, të trajtuar në rubrikën “Gjetje të tjera” të vendimit të Komisionit. Ky konflikt është krijuar pasi z. L. kishte shitur kamionin në pronësi të z. K. pa pëlqimin e tij dhe pa i dhënë lekët që i detyrohej. Ngjarja penale, në të cilën janë përfshirë dhe persona të tjerë,²⁴ ka ndodhur në janar të vitit

²¹ Referuar pasqyrave financiare, shoqëria “{***}” ShPK, për vitin 2013, rezulton me fitim neto 8.103.334 lekë (i shpërndarë); për vitin 2014, me fitim neto 1.350.590 lekë; për vitin 2015, shoqëria nuk ka shpërndarë fitimin e vitit 2014, ndërkohë ka realizuar fitim neto për këtë vit (2015) në vlerën 1.535.497 lekë; për vitin 2016, shoqëria nuk ka shpërndarë fitimin e vitit 2015, ndërkohë ka realizuar fitim neto për këtë vit (2016), në shumën 2.656.795 lekë.

²² Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë “{***}” ShPK, e cila është regjistruar në shtator 2016 për vitin 2017, ajo ka rezultuar me fitim neto në vlerën 1.713.225 lekë, ndërsa për vitin 2018, me fitim në vlerën 6.607.578 lekë.

²³ Dokument në të cilin përcaktohet kapitali themeltar në vlerën 5.208.387 lekë, si dhe të ardhurat e shoqërisë për periudhën 2005 – 2020 [Në vitin 2005, -- lekë; në vitin 2006, 31.077.928 lekë; në vitin 2007, 23.813.374 lekë; në vitin 2008, 13.995.544 lekë; në vitin 2009, 9.271.712 lekë; në vitin 2010, 22.750.517 lekë; në vitin 2011, 23.599.717 lekë; në vitin 2012, 11.628.187 lekë; në vitin 2013, --lekë; në vitin 2014, 526.320 lekë; në vitin 2015, 1.750.000 lekë; në vitin 2016, 3.636.142 lekë; në vitin 2017, 1.250.057 lekë; në vitin 2018, 600.240 lekë; në vitin 2019, 4253.576 lekë; në vitin 2020, 147.814.121 lekë].

²⁴ Si pjesëmarrës në këtë ngjarje përmendet dhe bashkëjetuesi i subjektit, informacion i evidentuar në media dhe në të dhënat TIMS, ku citohet se “po punohet për kapjen e shtetasit L. Q. i dt. {***}, banues në {***}, sepse për motive të dobëta janë goditur me mjete të forta, si dhe shtetasi L. Q. ka nxjerrë dhe ka qëlluar në ajër me një pistoletë TT kalibër

2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky fakt i ndodhur pikërisht 3 (tre) muaj para shitjes së kamionit të bashkëjetuesi, tregon se z. L. kishte vështirësi ekonomike.

16.12. Pretendimet e subjektit, në vlerësim të trupit gjykues, nuk gjejnë mbështetje në kronologjinë e transaksioneve të kryera, pasi nëse z. L. do të kishte vështirësi financiare, në janar të vitit 2016, shoqëria “{***}” ShPK e përfaqësuar prej tij, nuk do të blinte mjetin kamion, në prill të këtij viti nga shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 1.100.000 lekë, për ta rishitur pas dy javësh te bashkëjetuesi i subjektit, në vlerën 950.000 lekë, pra me një humbje prej 150.000 lekësh. Gjithashtu, mbetet e paqartë arsyeja se përse bashkëjetuesi i subjektit ka blerë një mjet pune kamion “vetëshkarkues” për ta mbajtur të përdorur dhe për ta shitur më pas 32.000 euro, me çmim rreth 3.6 herë më të lartë nga blerja, dhe prej të cilave t’i huazojë z. L. 28.000 euro. Natyrshëm, logjika ekonomike të çon drejt konkluzionit se, një shoqëri tregtare, që po kalon një vështirësi financiare, nuk blen një pasuri të luajtshme me çmim okazional për ta rishitur atë më lirë sesa e ka blerë, përkundrazi e anasjellta do të mbështeste një transaksion të arsyeshëm. Përpos sa më sipër, në kuadër të këtij procesi dhe të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që, përveç shpjegimeve të logjikshme sipas saj, të provonte nëpërmjet të dhënave, qoftë edhe nga burime të hapura, që nuk përbëjnë sekret tregtar, situatën e vështirë ekonomike të shoqërisë “{***}” ShPK dhe nevojën e ngutshme të saj për likuiditet, në prill 2016. Ndërsa kredia prej 12.000.000 lekësh, e financuar në vitin 2018, nga OTP Bank ShA, për L. dhe A. L., gjendet pa ndikim ligjor në kushtet kur shitja e mjetit dhe marrja e huas i përkasin vitit 2016, dhe aktet në dosjen gjyqësore nuk identifikojnë qëllimin/destinacionin e akordimit të kësaj kredie. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se veprimet e ndërmarra nga bashkëjetuesi dhe z. L. (shitja/blerja dhe marrëdhënia e huas) kanë pasur logjikë ekonomike dhe shpjegimet e saj duken si një përpjekje për të provuar se alternativa e vetme e z. L. për të zgjidhur vështirësinë e tij ekonomike, në vitin 2016, ishin transaksionet e kryera me bashkëjetuesin e subjektit.

16.13. Në shpjegimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ligji nuk e ngarkon atë me barrë prove për burimin e ligjshëm të pasurisë së fituar nga bashkëjetuesi apo bashkëshorti aktual për një pasuri të blerë gjatë bashkëjetesës, në rast se subjekti i rivlerësimit nuk ka interes pasuror në atë pasuri. Sipas subjektit, edhe nëse këto të ardhura nuk do të konsiderohen si të ligjshme, ky fakt nuk duhet të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për tri arsye: (i) Shuma e ardhur nga shitja e këtij mjeti është një pasuri e veçantë e bashkëjetuesit dhe subjekti nuk ka asnjë interes pasuror lidhur me të. (ii) E ardhura nga shitja e mjetit kamion nuk ka shërbyer për shtimin e pasurisë, por janë përdorur vetëm për shpenzime, nën vlerën 300.000 lekë. (iii) Shpenzimet e jetesës mund të mbuloheshin nga të ardhura të ligjshme, duke bërë që të ardhurat nga shitja e automjetit të mos kishin asnjë vlerë/ndikim në gjendjen financiare të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se këto pretendime nuk janë të bazuara, për arsye se: (i) Si burim për blerjen e mjetit kamion janë deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të dhuruara nga prindërit e saj pas shitjes së tokës. (ii) Referuar legjislacionit të zbatueshëm, përkatësisht ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) me ligjin nr. 85/2012, dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e

7.62 mm”. Procedimi penal nr. {***}, i vitit 2016, për veprat penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, “Prishje e qetësisë së rendit publik”, “Kanosje” parashikuar nga nenet 278, 274, 84 të Kodit Penal, është pezulluar për zbulimin e autorit/autorëve. Komisioni në vendim është shprehur se “në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit vëren se në asnjë prej akteve nuk rezulton të jetë thirrur apo komunikuar në çfarëdo lloji cilësie nga organet ligjzbatuese, shtetasi L. Q., për më tepër një thirrje apo komunikim nuk rezulton të jetë bërë as edhe pasi personi i dyshuar e dëshmoi shtetasin Q. si të përfshirë në këtë konflikt”.

konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe dispozitave të ligjit të posaçëm të këtij procesi, nenit 3, pika 13, të ligjit nr. 84/2016, bashkëjetuesi dhe bashkëshorti gëzojnë të dy cilësinë e personit të lidhur, dhe pozita e tyre në kuadër të këtij procesi është e njëjtë. (iii) Në deklaraten e pasurisë *vetting*, nga bashkëjetuesi janë deklaruar transaksionet e kryera për blerjen/shitjen e mjetit kamion, si dhe huaja prej 28.000 eurosh, dhënë z. L. L. Këto rrethana, sipas trupit gjykues, janë të mjaftueshme që transaksionet e mësipërme t’i nënshtrohen kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë nga organet e këtij procesi, sipas ligjit nr. 84/2016, e që në kuadër të po këtij procesi, përgjegjësia e barrës së provës i përket subjektit të rivlerësimit. Pretendimet mbi pasuritë vetjake konsiderohen si justifikime për të mbajtur sa më larg veprimet e kryera nga bashkëjetuesi, duke deklaruar se të ardhurat nga shitja e mjetit kamion/kthimi i huas janë shpërdoruar nga bashkëjetuesi dhe nuk janë investuar në asnjë formë apo mënyrë në dobi të ekonomisë familjare. Në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit në kuadër të këtij procesi mban përgjegjësi edhe për deklarimet e bëra nga personi i lidhur me të, ndaj ajo duhet të ishte më vigjilente ndaj veprimeve juridike të kryera nga bashkëjetuesi, si në kuadër të provueshmërisë dhe ligjshmërisë të tyre.

16.14. Lidhur me pretendimin se Komisioni nuk ka analizuar konceptin e deklarimit të rremë, mbi mënyrën e konsumimit të tij nga subjekti/bashkëjetuesi, në raport me veprën penale të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal²⁵, qëllimin e ligjit nr. 9049/2003 dhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 16, datë 11.11.2004, trupi gjykues, së pari, sjell në vëmendje përcaktimet në nenin Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, se *“Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal”*, në këto kushte, gjatë kontrollit të vlerësimit të pasurisë, analiza e organeve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi administrativ, nuk mund t’i referohet dispozitës së Kodit Penal. Nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni e bazon konkluzionin e tij për deklarimin e rremë, në arsyetimin se, pavarësisht që palët janë të lira të përcaktojnë çmimin e shitjes dhe pavarësisht se tregu i shitblerjes së automjeteve nuk ka çmime reference, vlera e shitjes së kamionit është jashtë logjikës ekonomike, si dhe ka pasur për qëllim të justifikojë me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro. Në këtë arsyetim, lidhur me huan, Komisioni ka mbajtur në konsideratë dhe faktin e kryerjes së veprimeve *cash* dhe pa asnjë dokument deri në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Në përfundim, Komisioni ka krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit/bashkëjetuesi ka kryer veprime fiktive në lidhje me mjetin kamion, si dhe ka kryer deklarim të rremë.

16.15. Për sa analizuar më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, lidhur me kryerjen e veprimeve fiktive dhe deklarimin e rremë. Në arritjen e këtij konkluzioni u mbajtën në konsideratë rrethana të tilla si: (i) Transaksionet e kryera për shitblerjen e kamionit dalin jashtë kufijve logjikë e ekonomikë të kësaj marrëdhënieje, pasi vlera e shitjes së mjetit, në datën 13.10.2016, në shumën 32.000 euro, nga bashkëjetuesi i subjektit, mjet i cili vetëm 6 (gjashtë) muaj më parë, më datë 29.04.2016, ishte blerë prej tij në shumën 950.000 lekë (ndërkohë që vetë shitësi e kishte blerë në vlerën 1.100.000 lekë). (ii) Transaksionet janë kryer jashtë sistemit bankar, duke iu shmangur filtrave të kontrollit për burimet e ligjshme të shumave përkatëse. (iii) Si rezultat i transaksionit të shitjes së mjetit nga bashkëjetuesi, justifikohet burimi financiar i huas në vlerën 28.000 euro, dhënë personit/përfaqësues ligjor i shoqërisë, nga e cila ishte blerë mjeti gjashtë muaj më parë. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se të gjitha këto veprime janë fokusuar në ngritjen e një mekanizmi

²⁵ Neni 257/a i Kodit Penal, *“Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”*.

transaksionesh përmes kryerjes së disa veprimeve fiktive (ku palët nuk kanë për qëllim të sjellin pasojën juridike që shprehin e dëshirojnë), të cilat mundësojnë justifikimin në qarkullimin civil të vlerës/çmimit, përmes shfrytëzimit të një marrëdhënieje shitblerje. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban parasysh dhe të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara në vitin 2019 ndaj z. L., lidhur me veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

16.16. Për këto arsye, trupi gjykues, pa marrë rolin e një gjykate civile, që konstaton pavlefshmërinë e veprimeve juridike në kontekst të zgjidhjes së pasojave të palëve, por në analizë të natyrës së ligjshme ose jo të transaksioneve të kryera, çmon se e gjithë veprimtaria për realizimin e këtyre veprimeve juridike përmban elemente që afektojnë legjitimitetin e tyre, pavarësisht faktit nëse janë kryer ose jo nga subjekti i rivlerësimit. Në vijim të analizës më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje se specifika e procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, qëndron në faktin se subjekt kontrolli në këtë proces është subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/tjetër i lidhur me të, dhe barra e provës në këtë proces zhvendoset te subjekti i rivlerësimit, pra i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet, duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit. Në zbatim të këtyre dispozitave, trupi gjykues, në rastin konkret, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, për veprimet fiktive të kryera nga bashkëjetuesi i saj, lidhur me mjetin tip kamion, jashtë çdo logjike ekonomike.

16.17. Lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit për tatimin mbi të ardhurën e realizuar nga diferenca e çmimit të shitjes së mjetit, në raport me atë të blerjes së tij dhe pagesën me vonesë të detyrimit tatimor, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim, përveç se ka konkluduar mbi veprime fiktive dhe deklaram të rremë, kësaj të ardhure i ka adresuar dhe paligjshmërinë në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Kolegji vlerëson se, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është gjendur në kushtet e deklaramit të rremë, analizimi i ligjshmërisë së të ardhurës në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese nuk është e nevojshme, dhe çmon pa relevancë e ndikim ligjor në vendimmarrjen e tij, shqyrtimin e shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, të cilat edhe në eventualitetin e pranimit të tyre si të bazuara, nuk do të shëronin paligjshmërinë e veprimeve të kryera, e për pasojë as të të ardhurave të përfituara prej tyre. Në kushtet kur trupi gjykues konkludon se subjekti ka kryer deklaram të rremë, pa peshë mbeten dhe shkaqet e ankimit lidhur me kohën dhe deklarimin e dhënies së huas, nëntor 2016 apo janar 2017.

16.18. Në konkluzion të këtij arsyetimi, trupi gjykues vlerëson se për shumën 28.000 euro, të dhënë hua z. L. L., subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në këto kushte, konfirmon diferencën negative lidhur me burimet e ligjshme për dhënien e huas në masën e konstatuar nga Komisioni. Situatat e trajtuara gjatë analizimit të kësaj çështjeje dhe konkluzionet mbi to e bëjnë të pazbatueshëm parimin e proporcionalitetit të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

16.19. Përpos sa më sipër, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në lidhje me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga diferenca e çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së kamionit, në vendim ka vlerësuar se subjekti ka dhënë deklarime kontradiktore, duke krijuar konfuzion te Komisioni në lidhje me qëndrimin e saj. Subjekti në ankim e kundërshton këtë konkluzion, me pretendimin se Komisioni nuk ka identifikuar, nëpërmjet ballafaqimit dhe bërjes transparente të deklarimeve kontradiktore të saj, ndërkohë që ajo ka mbajtur një qëndrim konsistent gjatë gjithë

procesit, se e ardhura nga shitblerja e automjeteve, në zbatim të legjislacionit tatimor,²⁶ jurisprudencës së Kolegjit²⁷ dhe shkresave të organeve tatimore,²⁸ është një e ardhur e patatueshme.

16.20. Trupi gjykues konstaton se për Komisionin nuk ka shkaktuar konfuzion qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi tatueshmërinë e të ardhurës, por mbi kohën e pagesës së detyrimit tatimor nga bashkëjetuesi, në kushtet kur subjekti: (i) Në përgjigjet e datës 13.04.2021, të pyetësit nr. 2, deklaroi se për këtë pasuri nuk është paguar tatimi mbi fitimin për diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes. (ii) Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit paraqet shkresën nr. {***} prot., datë 21.10.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, referuar së cilës L. Q. ka deklaruar të ardhura nga shitja e pasurisë në vitin 2016, shumën 3.114.000 lekë dhe ka paguar tatim për këtë të ardhur, në shumën 467.100 lekë. (iii) Gjatë seancës dëgjimore të datës 15.11.2021, e pyetur se përse nuk ishte investuar për të zbuluar nëse pagesa e tatimit ishte kryer që kur Komisioni i kishte drejtuar për herë të parë këtë pyetje, subjekti i rivlerësimit përgjigjet se një detyrim i tillë nuk duhej paguar dhe se ishte mjaftuar me një përgjigje të paqartë dhe evazive të bashkëjetuesit, me një memorie të paqartë për shkak të kalimit të viteve dhe për sa kohë nuk duhet paguar, nuk priste që ai të kishte bërë një pagesë tatimi. Në vijim, sa i përket kohës kur është paguar tatimi, subjekti shprehet se, sipas informacionit të dhënë nga bashkëjetuesi dhe ajo çka kupton nga shkresa, tatimi është paguar në vitin 2016. Në përfundim të seancës, i është kërkuar që, brenda datës 17.11.2021, të vinte në dispozicion të Komisionit një dokument, me të cilin të provonte datën e saktë të pagimit të tatimit. (iv) Me përgjigjen nr. {***} prot., datë 24.11.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, rezultoi se tatimi është paguar në datën 28 maj 2021. (v) Në seancën dëgjimore të datës 19.01.2022, subjekti ka sqaruar se bashkëjetuesi kishte kryer pagesën e këtij tatimi në datën 28.05.2021, me vullnetin e tij dhe pa u konsultuar me subjektin e rivlerësimit, vetëm nisur nga motive pozitive, duke menduar se mospagimi mund të dëmtonte subjektin e rivlerësimit në këtë proces. Në vijim, subjekti deklaroi se, nëse do të kishte dijeni për këtë pagesë, e para do t'i kishte kërkuar bashkëjetuesit ta kryente atë përpara kthimit të përgjigjes së pyetësit nr. 2, në prill 2021, e dyta, nuk do të priste për marrjen e informacionit pas njohjes me rezultatet e hetimit, në tetor 2021, dhe së treti, në seancë do të përgjigjej me vërtetësi dhe saktësi për datën e pagesës.

16.21. Në analizë të kësaj situate faktike, trupi gjykues konstaton se shpjegimet e subjektit lidhur me kohën e pagesës së tatimit nga bashkëjetuesi, në raport me aktet e depozituara krijojnë një konfuzion, të cilin subjekti e paraqet si një mungesë koordinimi mes saj dhe bashkëjetuesit, ndërkohë që sjelljet justifikuese të saj në formë shfajësimesh, në kuadër të këtij procesi, duket se tregojnë mungesë predispozicioni të saj për të qenë e saktë dhe e vërtetë në shpjegimet para Komisionit. Pagesa e tatimit nga bashkëjetuesi për një të ardhur të përfituar në vitin 2016, pikërisht pas pyetësit nr. 2, që Komisioni i kishte dërguar subjektit, nëpërmjet të cilit e pyeste për këtë fakt, nuk mund të injorohej nga subjekti i rivlerësimit, duke afektuar në këtë mënyrë besueshmërinë e deklarimeve të saj gjatë seancave dëgjimore në Komision.

²⁶ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006, i Ministrisë të Financave, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për sistemin e taksave kombëtare".

²⁷ Vendimin nr. 5/2021(JR), i Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit K. S.

²⁸ Shkresat nr. {***} prot., datë 21.10.2021 dhe nr. {***} prot., datë 24.11.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, shkresat nr. {***} prot., datë 12.11.2021 dhe nr. {***} prot., datë 23.11.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

17. Komisioni në vendim për këtë pasuri ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklarimet periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a”, pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
18. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit, me pretendimet se: (i) Konkluzioni i Komisionit në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit, në deklaratat periodike vjetore 2015 – 2016, nuk qëndron, pasi ligji i kohës nuk parashikonte një detyrim të tillë, i cili u parashikua për herë të parë në deklaratën e pasurisë *vetting*. (ii) Deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk është bërë, pasi objekt deklarimi janë të drejtat reale mbi sendet e paluajtshme dhe të luajtshme, të regjistruara në regjistrat publikë sipas parashikimeve të Kodit Civil, duke plotësuar dy kushtet e nevojshme të mbajtjes së këtij mjeti për t’u konsideruar në përdorim, kontratë noteriale përdorimi automjeti dhe regjistrimin e saj në DPSHTRr. (iii) Dy policat e sigurimit, në emër të subjektit të rivlerësimit, janë dhënë në kundërshtim me Kodin Civil, Kodin Rrugor dhe ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” etj., për sa kohë nuk plotësohen dy kushtet e sipërcituara. Kompanitë e sigurimit nuk duhet të lidhnin një kontratë sigurimi, pasi subjekti i rivlerësimit nuk kishte ndonjë lidhje me pronësinë apo përdorimin e mjetit. (iv) Neglizhenca në mosdeklarimin e mbajtjes së automjetit në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk duhet të konsiderohet deklarim i pasaktë/i pamjaftueshëm sipas ligjit nr. 84/2016. Kjo pasaktësi të mos shërbejë për penalizimin e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk plotësohen dy kushtet e nevojshme të mbajtjes së mjetit për t’u konsideruar në përdorim dhe në kushtet e mungesës së konfliktit të interesit me z. P.
19. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore lidhur me këtë automjet, trupi gjykues konstaton se:
- 19.1. Në përgjigjet e datës 06.01.2020, të pyetjes nr. 8, të pyetësorit standard mbi përdorimin e pasurive të regjistruara në emër të një personi tjetër dhe periudhën e përdorimit të tyre, subjekti i rivlerësimit deklaron se ka përdorur automjetin tip “Peugeot 207”, me targë {***}, të z. F. P. Këtë automjet, subjekti i rivlerësimit shprehet ta ketë përdorur fillimisht në muajin dhjetor 2015 deri në fillim të muajit janar 2016, duke negociuar blerjen e tij. Për shkak të problemeve të rënda shëndetësore pas lindjes së vajzës, si dhe duke qenë me leje lindje, subjekti nuk kishte më interes për blerjen e automjetit, duke ndërprerë kështu negociatat dhe duke i kthyer mjetin pronarit. Këtë automjet, subjekti i rivlerësimit deklaron ta ketë përdorur edhe në periudhën dhjetor 2016, deri në muajin shkurt 2017. Edhe pse pronari i automjetit kishte rënë dakord me bashkëjetuesin e subjektit për shitjen e tij, kjo marrëveshje nuk u arrit, pasi banka pranë së cilës ai ishte kredimarrës për blerjen e këtij mjeti, nuk kishte dhënë pëlqimin për shitjen e tij. Në muajin shkurt 2017, automjeti iu kthye pronarit dhe subjekti finalizoi kontratën për blerjen e automjetit të markës “Volkswagen”, tip “Golf 5”,²⁹ të cilin e disponon ende. Së bashku me përgjigjet e datës 06.01.2020, subjekti i rivlerësimit paraqet deklaratën noteriale të z. F. P., i cili konfirmon deklarimet e subjektit, si dhe aktet e pronësisë mbi këtë

²⁹ Nëpërmjet kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.02.2017, mes shitësit E. K. dhe blerësit Enkeleda Kapedani, kundrejt çmimit 360.000 lekë, paguar para redaktimit të kontratës, jashtë zyrës së noterisë. Konfirmuar nga DPSHTRr-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.01.2020.

automjet³⁰. Referuar informacionit të përcjellë nga DPSHTRr-ja³¹, mjeti rezulton ende në pronësi të z. P.

19.2. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 27.01.2020, me lëndë “Konfirmim për mbulimin në sigurim”, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë siguruar pranë shoqërisë së sigurimit {***}, si përdorues i këtij automjeti, për periudhat 16.12.2015 – 15.12.2016 dhe 16.12.2016 – 15.12.2017.

19.3. Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit për mosdeklarimin e përdorimit të këtij automjeti në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në prapësimet mbi këto rezultate, ashtu si edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit, ka sqaruar se:

19.3.1. Mosdeklarimi, në deklaratat periodike vjetore 2015 – 2016, ka ardhur pasi legjislacioni i kohës, konkretisht neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 nuk parashikonte një detyrim të tillë, arsye kjo për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk mund të penalizohet. Për herë të parë, detyrimi për të deklaruar pasuritë në përdorim është përcaktuar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

19.3.2. Për mosdeklarimin në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit sqaron: *së pari*, në interpretim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, i referohet doktrinës juridike dhe bën një trajtim teorik dhe ligjor të termave: *pronësi, përdorim dhe posedim*, për të përcaktuar dallimin mes tyre dhe për të sqaruar ndryshimin mes nocionit të posedimit/përdorimit dhe mbajtësit të thjeshtë të sendit. *Së dyti*, pas një interpretimi të dispozitave ligjore,³² subjekti i rivlerësimit pretendon se të konsiderohesh përdorues i sendit, si e drejtë reale duhet të jetë nënshkruar një kontratë noteriale mes pronarit dhe përdoruesit, dhe kjo kontratë të regjistrohet në DRShTRr. Subjekti i rivlerësimit përmend qëndrimin në jurisprudencën e Kolegjit,³³ sa i përket pasurive të paluajtshme.

19.3.3. Nga përmbajta e nenit 93 të Kodit Rrugor, e parë në unitet me nenin 235, 259 dhe 260 të Kodit Civil, rezulton se kontrata e përdorimit të automjeteve duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në degën përkatëse të DPSHTRr-së. Pasi regjistrohet kontrata e përdorimit si e drejtë reale në këtë regjistër, edhe siguracioni i mjetit del në emër të përdoruesit, si parashikuar në nenin 4, pika 3 e ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar. Nëse nuk formalizohet kontrata e përdorimit të automjeteve me akt noterial dhe nëse nuk është regjistruar dhe bërë ndryshimi në lejen e qarkullimit, kompanitë e sigurimit nuk mundën të lëshojnë siguracion në emër të një personi që nuk e ka këtë titull, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me ligjin, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret.

³⁰ Aktet: (i) kontratë nr. {***}, nënshkruar ndërmjet shitësit shoqërisë “{***}” ShPK dhe blerësit F. P., për blerjen e automjetit “Peugeot” modeli 207, në vlerën 17.143 euro; (ii) kontratë huaje nr. {***}, datë 26.05.2010, mes huadhënësit Alpha Bank Albania ShA dhe huamarrësit F. P. dhe N. P., për shumën 12.000 euro, financuar për blerjen e automjetit të markës “Peugeot 207”; (iii) kontratë për vendosjen e barrës sigurorese nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2010, për vendosjen në favor të bankës të barrës sigurorese mbi automjetin.

³¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.06.2021 dhe shkresën nr. {***} prot., datë 04.10.2021.

³² Referuar nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016; nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003; deklaratës së pasurisë *vetting* që, në faqen 5 të saj, përcakton shprehimisht pasuritë objekt deklarimi; neneve 143, 193, 235, 259, 260, 786 të Kodit Civil; nenit 93 të Kodit Rrugor; nenit 4, pika 3 e ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

³³ Shih vendimin nr. 11/2019 (JR), paragrafi 21.5, vendimin nr. 35/2020 (JR), paragrafi 26, vendimin nr. 3 (JR), datë 03.11.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

19.3.4. Mbajtja nga subjekti i rivlerësimit i automjetit në dy periudha shumë të shkurtra kohore, dhjetor 2015 – janar 2016 dhe dhjetor 2016 – shkurt 2017, nuk përbën një të drejtë reale, siç është ajo e përdorimit të sendit. Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas subjektit, ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor, nisur dhe nga tradita e deklaratave periodike vjetore deri në atë moment kur nuk ishte kërkuar ndonjëherë deklarimi i pasurive në përdorim, si edhe për shkak të kohës së shkurtër të mbajtjes së automjetit në kohën e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, rreth 1 muaj e 14 ditë para dhe 2 javë pas plotësimit të kësaj deklarate. Subjekti i rivlerësimit shpreh se ishte në dijeni të policave të sigurimit për automjetin, për sa kohë ishte ajo porositësja në kontratat e sigurimit, por thjesht nuk e ka kuptuar që deklarata e pasurisë *vetting* kërkonte këtë lloj deklarimi, pasi në fakt mbajtja e sendit përkohësisht nuk mund të konsiderohej përdorim sipas konceptit të Kodit Civil.

19.4. Trupi gjykues vlerëson se, në kuptim të legjislacionit të zbatueshëm të rivlerësimit, përkatësisht bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të përmbushjes së objektit të kontrollit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjektet e rivlerësimit kanë pasur detyrimin që, në deklaratën e pasurisë *vetting*, të deklaronin me vërtetësi dhe plotësi të gjitha pasuritë në pronësi e përdorim dhe burimin e krijimit të tyre. Interpretimi doktrinor i tagrave të pronarit apo interpretimi logjik i dispozitave ligjore, nuk e përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi për të deklaruar për efekt të këtij procesi pasurinë në përdorim, automjet “Peugeot”, në pronësi të F. P., për më tepër kur rezulton e siguruar si përdoruese e automjetit në dy vite, si dhe ka qenë duke e përdorur atë në kohën e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Në këto kushte, për mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting*, të përdorimit të këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, duke u gjendur në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

20. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është gjendur në situatat e parashikuara në nenin 33, pikat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, ndaj saj, për rrjedhojë, gjen zbatim neni 61, pika 3 e këtij ligji, për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e kontrollit të figurës

21. Për këtë kriter, Komisioni, pasi ka marrë në konsideratë rezultatet e hetimit, si dhe gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, ka konkluduar se bashkëjetuesi i subjektit ka pasur kontakt me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimeve të shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 38/4, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisioni konstaton gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, duke marrë në konsideratë faktin e ndërthurjes së interesave personale të saj dhe bashkëjetuesit të saj (shitblerja e kamionit dhe huaja) me një person të dënuar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, dhe se do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj saj.
22. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se për raportin e përditësuar të DSIK-së, Komisioni nuk ka dhënë një vlerësim përfundimtar lidhur me dyshimet e ngritura për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Komisioni nuk ka dhënë një qëndrim përfundimtar lidhur me këto dyshime, nëse i ka gjetur apo jo të bazuara, pas analizës së të gjitha provave të administruara dhe të shqyrtuara në seancë.

23. Trupi gjykues konstaton që Komisioni, të dhënat e raportit të DSIK-së dhe dosjet e administruara, si rrjedhojë e indicieve pranë këtij institucioni, vendosi t'i shqyrtojë gjerësisht në kontekstin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, dhe gjenden të analizuara nën rubrikën "Rivlerësimi profesional/çështje të tjera të trajtuara", të vendimit të tij. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk duhej të ngrihej si shkak ankimi, në kushtet kur të dhënat e raportit të DSIK-së nuk kanë shërbyer për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 61, pikat 2 apo 3 të ligjit nr. 84/2016, dhe kur konkluzioni për këtë kriter nuk është mbështetur në to. Në kuadër të kontrollit të kriterit të figurës, nga Komisioni u trajtua "Gjetja dhe mendimi" i vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, nr. {***} prot., datë 20.01.2022.
24. Lidhur me "Gjetjen dhe mendimin" e ONM-së, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto shkaqe ankimore: (i) Konkluzionet e Komisionit për penalizimin e subjektit të rivlerësimit për këtë kriter nuk janë të drejta dhe as të bazuara në ligj e në prova. (ii) Është tërësisht alogjike të ngarkosh me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, për mungesën e dijenisë rreth afërsisë apo largësisë së raportit të bashkëjetuesit me të tretë, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk është pjesë e atij raporti dhe as nuk e mohon atë. (iii) Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime kontradiktore gjatë hetimit administrativ dhe në vijim, rreth marrëdhënies së bashkëjetuesit me z. L. L., është i pabazuar. (iv) Komisioni nuk duhet të kishte konkluduar që subjekti nuk ishte bindëse për mungesën e dijenisë, por duhet të kishte provuar, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, dijeninë e saj/bashkëjetuesit për dënimin e z. L. L., përpara se të konkludonte për mosdeklarimin apo mosplotësimin me saktësi të deklaratës për kontrollin e figurës. (v) Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë rrethanat e rezultuara, në përputhje me pikën 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, dhe të konkludonte se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e figurës.
25. Trupi gjykues, në analizë të shkaqeve të ankimit dhe akteve të dosjes gjyqësore të Komisionit konstaton se:
- 25.1. Më datë 20.01.2022, nga vëzhguesi ndërkombëtar paraqitet në Komision "Gjetje dhe mendim" nr. {***} prot., datë 20.01.2022. -- Gjetje sipas së cilës, *L. L. është dënuar për veprën penale të mbajtjes, transportit dhe shitjes së lëndëve psikotrope (trafikimi i narkotikëve), në Itali, të kryer në bashkëpunim, dhe është dënuar përfundimisht me 7 vite burgim dhe me gjobë prej 35.000 euro, nga Gjykata e Apelit të Napolit, më 7 mars 2012. Për shkak të një faljeje të përgjithshme ("indulto") në Itali (jo amnisti, prandaj përgjegjësia penale ka mbetur e njëjtë), dënimi përfundimtar është ulur në 3 vite burgim dhe 10.000 euro. Për L. L. është caktuar edhe masa e sigurimit "Liberta vigilata", detyrim paraqitje për një periudhë prej 3 (tre) vitesh.*
- Për këtë arsye, vëzhguesi ndërkombëtar paraqet mendimin rreth: -- nevojës që Komisioni të riçelë hetimin, në mënyrë që të lejojë marrjen e kësaj gjetje që të konsiderohet provë, që të lejojë përmbushjen e parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe të kontradiktoritetit; -- nevojës që Komisioni të vlerësojë nëse besimi i publikut është cenuar nga subjekti i rivlerësimit me anë të sjelljes dhe kontakteve, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të etikës. L. është cilësuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëjetuesin e saj dhe, prandaj, ishte e rëndësishme të sigurohej informacion si ky i paraqitur në këtë dokument.*
- 25.2. Vëzhguesi ndërkombëtar, në bazë të kërkesave dhe kompetencave të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga ligji i vetting-ut është vënë në dijeni, nëpërmjet burimeve konfidenciale, mbi informacionin e paraqitur në këtë gjetje. Ky informacion është konsideruar prej tij si rrethanë konkrete, ndërsa konkluzioni është mendimi rreth nevojës për t'i kërkuar shpjegime

subjektit të rivlerësimit rreth përmbajtjes së kësaj gjetjeje dhe për ta konsideruar si cenim të mundshëm të besimit të publikut në vlerësimin tërësor të çështjes, së bashku me informacione të tjera të siguruar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit. Në të njëjtën datë, me depozitim të “Gjetje dhe mendim” të vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni merr vendim për riçeljen e hetimit administrativ dhe kryerjen e hetimeve shtesë.

25.3. Në kuadër të kësaj “Gjetje dhe mendim”, vëzhguesi ndërkombëtar, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 25.01.2022,³⁴ paraqet “Certifikatën e Dëshmisë së Penalitetit,” të lëshuar nga Sistemi Informativ i Dëshmimeve, Ministria e Drejtësisë, Itali, për L. L., i cili rezulton të jetë dënuar me vendim në datën 07.03.2012, të Gjykatës së Apelit Napoli, i cili ka marrë formë të prerë më datë 22.01.2013, pasi është deklaruar i papranueshëm rekursi nga Gjykata e Kasacionit Romë. Ky individ është dënuar për veprën penale “Mbajtje, transport dhe shitje e lëndëve narkotike”, e vazhduar, në bashkëpunim, me 7 vjet heqje lirie dhe gjobë 35.000 euro, me dënime plotësuese, -- përjashtim i përhershëm nga zyrat publike, -- përjashtim ligjor për të gjithë kohëzgjatjen e dënimit. Masa e sigurisë, liri e mbikëqyrur për 3 vite. Për shkak të faljes, dënimi i tij përfundimtar rezultoi heqje lirie 3 vite, gjobë 10.000 euro.

25.4. Në funksion të hetimit administrativ, Komisioni administroi informacion mbi kallëzimet/procedimet penale në ngarkim të z. L., si dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore të tij³⁵. Referuar këtij informacioni, në ngarkim të z. L. L. rezulton të jenë regjistruar procedimet penale: -- Nr. {***}, të vitit 2013, për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, pushuar më datë 14.04.2014, pasi është amnistuar ndjekja penale; -- Nr. {***}, i vitit 2015, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a, i cili është dërguar për gjykim më datë 15.07.2015; -- Nr. {***}, i vitit 2019 dhe nr. {***}, i vitit 2019, për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180, respektivisht, dërguar për gjykim/ nën hetim; -- si dhe tri kallëzime penale, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit. Ndërkohë që është deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 06.03.1993, për veprën penale “Përvetësim i pasurisë socialiste”, më datë 08.10.2004, për veprën penale “Prerje e paligjshme e pyjeve” dhe më datë 01.02.2016, për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorike”, rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar informon se në emër të z. L. L. është regjistruar verifikimi pasuror me nr. {***}, datë 23.04.2012, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe, pas kryerjes së hetimeve, është vendosur dërgimi për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 13.12.2019. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.04.2022, sqaron se nuk ka asnjë vendim penal të huaj të njohur nga autoritetet shqiptare në lidhje me z. L. L.

25.5. Me rezultatet e këtij hetimi, Komisioni ka konstatuar se: (i) duket se personi i lidhur/bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka pasur kontakt të papërshtatshëm me z. L. L., në shkelje me nenin 38 të ligjit nr. 84/2016; (ii) duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar kontaktin e papërshtatshëm të bashkëjetuesit me këtë person, përcaktuar në deklaratën për kontrollin e figurës, në shkronjën “d” dhe “f”, në pjesën 5, “Të dhënat për sigurinë”, për shkak të hyrjes në marrëdhënie kontraktore shitblerje dhe huadhënie/interesa

³⁴ Dokumentacioni mbi dënimin e z. L. u vu në dispozicion të Komisionit edhe nga shkëmbimi zyrtar nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë së Italisë.

³⁵ Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresat nr. {***} prot. dhe nr. {***} prot., datë 10.06.2021, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.04.2022.

pasurorë, të bashkëjetuesit me këtë person. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të barrës së provës, me sqarimet e datës 23.03.2022, ndër të tjera, ka prapësuar si më poshtë:

25.5.1. Referuar rrethanave lehtësuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “dh” të pikës 5, të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë kategorike, dënimi i këtij personi nuk mund të ndikojë në jetën e subjektit të rivlerësimit, duke mos pasur asnjë lidhje me të. Shkaku i njohjes mes bashkëjetuesit dhe tij është se kanë lindur në të njëjtin fshat, {***}, Tiranë, por nuk kanë pasur ndonjëherë lidhje shoqërore me njëri-tjetrin, të paktën deri në vitin 2016, njohja e tyre ka qenë normale si dy djem nga e njëjta zonë. Bashkëjetuesi nuk ishte në dijeni të jetës personale të z. L., pasi prej vitit 2000, ky i fundit jetonte në Tiranë dhe ishte shpërngulur zyrtarisht në vitin 2003, duke mos pasur raport, nga koha e largimit në vitin 2003, apo procedimit në Itali në vitin 2004, deri në kohën e kryerjes së veprimeve juridike në vitin 2016. Bashkëjetuesi nuk ka pasur dijeni rreth problemeve ligjore të këtij personi në Itali apo në ndonjë vend tjetër, duke mos pasur asnjë lloj shoqërie me të në kohën e procedimit e as të dënimit të tij.

25.5.2. Sipas subjektit të rivlerësimit, nuk duhet të prezumohet dijenia e bashkëjetuesit rreth dënimit të këtij personi, pasi nuk ka asnjë lloj prove që të tregojë se mes tyre ka pasur marrëdhënie shoqërie, miqësie, pune apo interesi nga koha e procedimit në vitin 2004 deri në vitin 2016, kur janë kryer veprimet juridike mes tyre. Mjetet e informimit masiv (media e shkruar dhe vizive) nuk pasqyrojnë asnjë rrethanë apo indikacion që ky person ishte dënuar për veprimtari kriminale. Masa e sigurimit ndaj tij, periudhë prove për 3 vite, tregon që ky person nuk ka qenë i arrestuar, pra nuk ka munguar fizikisht në Shqipëri, që të mund të prezumohej se mund t’i kishte ndodhur diçka jashtë vendit. Bashkëjetuesi, sipas subjektit të rivlerësimit, ishte në dijeni për biznesin në fushën e ndërtimit të z. L. dhe që vazhdimisht shkonte jashtë vendit dhe lëvizte lirisht, si rregull për personat që kanë probleme me ligjin nuk u lejohet kalimi në pikat kufitare. Për sa kohë nuk kishte informacion në zonën e vendlindjes së tyre rreth dënimit, sipas perceptimit të subjektit të rivlerësimit, ai kishte zgjedhur ta mbante të fshehtë faktin e çështjes penale në Itali.

25.5.3. Përfshirja e një personi në një veprimtari kriminale, parashikuar nga pika 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas subjektit kërkon dy kushte kumulative: a) dijeninë e subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur jo vetëm për kontaktin e papërshtatshëm, por b) edhe të shkakut të papërshtatshmërisë, pra përfshirjes së personit në veprimtari kriminale. Referuar të dhënave të TIMS rezulton se ky person ka pasur hyrje-dalje në vitet 2004, 2005, 2006, 2007, si dhe nuk rezulton të ketë datë dalje në vitin 2012, kur është dënuar me vendim të formës së prerë në Itali, gjë që tregon se nuk e ka vuajtur asnjëherë këtë dënim. Po kështu, nuk ka asnjë vendim të gjykatave shqiptare mbi ekstradimin apo njohjen e vendimit penal të gjykatave të huaja, si dy nga format e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe për sa kohë shteti italian nuk ka njoftuar shtetin shqiptar rreth këtij dënimi, subjekti i rivlerësimit shprehet se i lind e drejta të prezumojë që ky person nuk ka qenë në dijeni të ecurisë së procesit penal dhe fatin e çështjes së tij. Në dëshminë e penaltetit nr. {***}, datë 17.03.2022, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ai figuron i padënuar. Bashkëjetuesi nuk ka qenë asnjëherë rreth i ngushtë shoqëror me të, por njiheshin vetëm si bashkëfshatar deri në vitin 2016, vit në të cilin bashkëjetuesi kishte rënë në dijeni, nëpërmjet personave të tretë, se z. L. L. do të shiste një mjet me çmimin 1.000.000 lekë, të cilin e nxori në shitje pa ditur që bashkëjetuesi do të ofrohej ta blinte dhe pa ditur shumën që ai do të ofronte.

25.5.4. Asnjë nga organet ligjzbatuese nuk e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për aktivitetin kriminal të z. L., e jo vetëm kaq, por as kanë pasur dijeni për këtë veprimtari të tij, pasi nuk është evidentuar në asnjë nga raportet e DSIK-së. Në kushtet kur shteti shqiptar, nëpërmjet institucioneve

të tij dhe mjeteve të informimit, nuk e ka ditur këtë fakt, nuk mund të pretendohet që ta dijë subjekti i rivlerësimit. Përpara kryerjes së veprimeve juridike në vitin 2016, bashkëjetuesi nuk kishte asnjë raport shoqëror me z. L., asnjë udhëtim jashtë shtetit dhe njohja me të ka qenë thjesht përshëndetje kortezie. Kontaktet mes tyre, sipas subjektit, kanë zgjatur nga viti 2016, me lidhjen e kontratës së huas dhe kanë përfunduar në mënyrë përfundimtare me mbarimin e efekteve të saj, në vitin 2018. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit depoziton deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2022, të bashkëjetuesit, z. L. Q., i cili, përpos sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, deklaron se me porosi të bashkëjetueses ka pyetur këtë person para se të lidhnin kontratën verbale të huas dhe ai e ka mohuar të ketë ndonjë problem të tillë. Deklaruesi shprehet se është vënë në dijeni të dënimit të z. L. në Itali, vetëm pasi bashkëjetuesja i ka komunikuar rezultatet e hetimit administrativ të kryera nga Komisioni. Ai deklaron gjithashtu se shoqëria e tij është e ndarë dhe zhvillohet pa praninë e bashkëjetueses, e cila nuk mund të ishte në dijeni të një fakti që nuk dihej as prej tij.

25.5.5. Me konsideratë rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, të parashikuar në pikën 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, subjekti pretendon se bashkëjetuesi ishte në padijeni të plotë të faktit dhe as që mund të vihet në diskutim dijenia e subjektit të rivlerësimit, për një person të cilin nuk e ka takuar kurrë. Sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.07.2018, kur ky person marrëdhënien me bashkëjetuesin e ka interpretuar si një marrëdhënie të mirë familjare e miqësore, subjekti sqaron se mënyra se si një individ e percepton raportin shoqëror të afërt apo të largët me një të tretë është relative dhe subjektive. Fakti që ai është shprehur se ka marrëdhënie të tillë me bashkëjetuesin e saj, nuk do të thotë që është e njëjta gjë edhe për këtë të fundit. Ky detaj forcon faktin që bashkëjetuesi nuk ishte në dijeni të dënimit të tij në Itali, përndryshe nuk do të lejonte përdorimin e termave të tillë në deklaratën e vitit 2018.

25.5.6. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, nëse ajo apo bashkëjetuesi do të ishin në dijeni të këtij dënimi: (i) nuk do të kishte sjellë me vullnetin e saj, deklaratën noteriale të lëshuar nga L. L., ku ai pranon lidhjen e ngushtë familjare dhe miqësore me bashkëjetuesin; (ii) dhe pyetjeve, gjatë seancës dëgjimore të datës 19.01.2022, do t'i përgjigjej me bindje dhe vendosmëri, duke thënë se ata nuk kanë qenë dhe as nuk janë shokë, e se nuk kanë asnjë lloj raporti me njëri-tjetrin, por deri në atë çast nuk e kishte pyetur ndonjëherë bashkëjetuesin lidhur me raportin me këtë person, pasi nuk paraqiste interes të veçantë për të. Do të ishte tërësisht absurde dhe alogjike që të ngarkohet me përgjegjësi për dënimin e një personi, me të cilin bashkëjetuesi ka hyrë në marrëdhënie të përkohshme juridike dhe që nuk kishte kurrfarë lidhje me jetën e tyre, e aq më pak me punën e subjektit të rivlerësimit.

25.5.7. Nëpërmjet këtyre prapësimeve, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje qëndrime të mbajtura nga Komisioni në jurisprudencën e tij,³⁶ për disa raste të tjera, jo vetëm të ngjashme, por edhe më të disfavorshme në raport me rastin konkret, në të cilat Komisioni nuk ka marrë në konsideratë gjetjet e ONM-së, duke konsideruar bindëse shkaqet e mospasjes dijeni për dënimin dhe mosdeklarimin e këtij fakti. Subjekti i rivlerësimit kërkon që raste të ngjashme të trajtohen njëllë, si një e drejtë kushtetuese

³⁶ Vendimin nr. 79, datë 22.11.2018 dhe vendimin nr. 191, datë 26.07.2019, të Komisionit.

e barazisë së shtetasve para ligjit.³⁷ Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje dhe raste³⁸ nga jurisprudenca e Komisionit, në të cilat është disponuar me shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit për deklarim të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vëllain dhe kunatin respektivisht, ndërkohë që në rastin konkret, as subjekti i rivlerësimit dhe as bashkëjetuesi nuk kishin dijeni të dënimit të z. L. L. dhe as nuk mund të prezumohet dijenia e tyre.

25.5.8. Nisur nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit përmend se: (i) Nuk ka shqyrtuar asnjë çështje gjyqësore në ngarkim të z. L. L., pra nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit. (ii) Provohet ekzistenca e njohjes, por jo e miqësisë mes bashkëjetuesit dhe këtij personi, e as nuk mund të ngrihen dyshime për marrëdhënie familjare mes tyre. (iii) Në vendimin e dënimit rezulton se ai është arrestuar në vitin 2004, në Itali, fakt i cili përjashton mundësinë e njohjes së kësaj rrethane nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2016, pasi subjekti dhe bashkëjetuesi kanë konsoliduar marrëdhënien në vitin 2013. (iv) Shkaku i njohjes mes tyre është thjesht vendlindja, por nuk ka ekzistuar asnjë marrëdhënie mes tyre deri në vitet 2016 – 2018. (v) Nuk ka rezultuar e provuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer ndonjë udhëtim me ndonjë automjet apo në shoqërinë e këtij personi ose të ndonjë familjari të tij. (vi) Nuk ka pasur asnjëherë ndonjë takim me këtë person. Për sa kohë nuk u provua: (a) njohja me të dhëna bashkëshoqërimi nga sistemi TIMS, (b) njohja me të dhëna mbi dënueshmërinë nga aksesit në media apo (c) njohja dhe regjistrimi i vendimit të huaj nga autoritetet shqiptare, nuk mund të shtrohet për diskutim, nëse subjekti ka plotësuar apo jo me vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës.

25.6. Në mbështetje të sa parashtruar më sipër, trupi gjykues konstaton se z. L. L. është i dënuar në Itali për një vepër penale, që për efekt të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, e kategorizon atë “Person të përfshirë në krimin e organizuar”. Pavarësisht pretendimeve dhe argumenteve të subjektit të rivlerësimit, për të provuar mungesën e dijenisë së saj dhe personit të lidhur mbi këtë fakt, nuk mund të mohohet se, në kuadër të procesit të rivlerësimit, rezultoi e provuar se bashkëjetuesi dhe ky person kanë hyrë më shumë se një herë në marrëdhënie mes tyre, transaksioni i shitblerjes së mjetit kamion dhe dhënia e huas pas shitjes të tij, për të cilat është konkluduar në fiktivitet veprimeve. Ka qenë natyra e këtyre veprimeve, si dhe qëndrimet e mbajtura lidhur me marrëdhënien e bashkëjetuesit me z. L., që kanë ngjitur dyshime te Komisioni, duke i bërë jobindëse deklaratimet rreth raportit të tyre.

25.7. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, për deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit për marrëdhënien e bashkëjetuesit me z. L. L., trupi gjykues analizoi qëndrimet e subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e saj dhe deklaratat e bashkëjetuesit, në kuadër të kriterit të pasurisë, pra para depozitimit të “Gjetjes dhe mendimit” të vëzhguesit ndërkombëtar, me shpjegimet pas depozitimit të tij.

³⁷ Një rast tjetër të ngjashëm, subjekti i rivlerësimit përmend dhe vendimin nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit R. S., ku subjekti i rivlerësimit ka pasur një policë sigurimi për mjetin në emër të shtetasit F. D., të përfshirë në krim të organizuar, pavarësisht kësaj lidhje shoqërore dhe familjare të konfirmuar midis gjyqtarëve dhe personave të përfshirë në krim të organizuar, fakt për të cilin ishte shkarkuar nga detyra dhe bashkëshorti i saj, Komisioni ka mbajtur qëndrim që nuk provohet që subjekti R. S. të ketë lidhje me këta shtetas dhe se nuk provohet se ata mund të ndikojnë në punën e saj.

³⁸ Shih vendimin nr. 452, datë 24.09.2021, vendimin nr. 39, datë 17.07.2018 dhe vendimin nr. 37, datë 16.07.2018, të Komisionit.

- Në deklaratën noteriale të vitit 2018, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, z. L. L. e konsideron marrëdhënien me bashkëjetuesin e subjektit të rivlerësimit: *“një marrëdhënie mirëbesimi (marrëdhënie e ngushtë familjare dhe miqësore) që ekziston midis nesh”*, dhe bashkëjetuesi i subjektit, si një nga deklaruesit/nënshkruesit në këtë akt noterial, konfirmon si të vërteta deklaratimet e tij.
- Gjatë seancës dëgjimore të datës 19.01.2022, e pyetur lidhur me arsyen se pse z. L. L., në kushtet kur kishte nevojë për mjete monetare, nuk e shiti vetë mjetin kamion në shumën 32.000 euro, sa ç’ ishte vlera reale e tij, e shitur nga bashkëjetuesi, subjekti i rivlerësimit përgjigjet se: *“Arsyeja është, e para, njohja shoqërore midis shitësit dhe bashkëjetuesit, dhe arsyeja e dytë është mundësia ekonomike”*.
- Në deklaratën noteriale të vitit 2022, pas paraqitjes së “Gjetjes dhe mendimit” të vëzhguesit ndërkombëtar, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit shprehet se: e njeh z. L. L., pasi të dy kanë lindur në {***}, por nuk ka pasur marrëdhënie shoqërore deri në vitin 2016, kur lidhën kontratën e shitjes dhe të huas, marrëdhënie e cila ka vazhduar deri në vitin 2018, kur kanë përfunduar efektet e tyre dhe pas kësaj nuk kanë pasur asnjë raport midis tyre, pasi përfundoi shkaku që i lidhte.
- Gjatë seancës dëgjimore të datës 16.05.2022, komisionerja kryesuese ngre shqetësimin se subjekti i rivlerësimit, gjatë parashtrimeve dhe shpjegimeve të saj, tenton maksimalisht të mbajë larg këtë marrëdhënie miqësore, familjare, shoqërore, fëmijërie, pra duke pasur një tendencë të theksuar se nuk ekziston një marrëdhënie miqësore. Në vijim, subjekti të rivlerësimit i është drejtuar pyetja, se si e shpjegon ajo faktin që, kur nuk ka një marrëdhënie kaq miqësore, bashkëjetuesi i jep këtij personi një hua në shumë të konsiderueshme, prej 28.000 eurosh, fillimisht pa dokument, dhe më pas, për efekt dhe të procesit të *vetting*-ut, bëhet kontrata fillestare e huas, me interes dhe pas një jave bëhet një kontratë tjetër, në të cilën hiqet interesi, dhe nuk parashikohet as kolateral, *“Çfarë garancie kishit ju, kur një njeri që e njihni, por nuk e keni mik dhe shok dhe hyrje-dalje familjare [...] që do t’jua rikthejë ju këto 28.000 euro, kur e dinit që ishte keq nga gjendja ekonomike [...]”*. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, përgjigjet se distancohet në mënyrë kategorike nga kjo marrëdhënie dhe nga ky person, dhe se në rastin konkret ka qenë bashkëjetuesi ai që ka dhënë një shumë të konsiderueshme huaje pa kolateral, pasi z. L. L. nuk është një person tërësisht i panjohur për të, sepse njihen që në fëmijëri. Bashkëjetuesi, sipas saj, nuk dyshonte që kjo shumë nuk do t’i kthehej, duke kujtuar se një nga mjetet juridike për të garantuar të drejtën është edhe gjykata. Ky raport, shprehet subjekti, është krijuar jashtë saj, dhe nuk mund të japë detaje lidhur me të.

25.8. Trupi gjykues vëren se konstatimet e Komisionit lidhur me qëndrimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi marrëdhënien e bashkëjetuesit me z. L. L. qëndrojnë, pasi në kuadër të dhënies së huas me kontratë verbale, niveli i besimit mes tyre ishte i lartë, sa nuk u pa i nevojshëm formalizimi me shkrim i huas, për shkak të marrëdhënies shoqërore dhe mirëbesimit, dhe pas njohjes me të dhënat në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, njohja që nga fëmijëria u kufizua në një shoqëri vetëm për periudhën 2016 – 2018, pra vetëm gjatë marrëdhënies kontraktore. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se një marrëdhënie mirëbesimi nuk nënkupton një marrëdhënie të ngushtë shoqërore apo se perceptimi i z. L. për një marrëdhënie shoqërore dhe familjare është relativ dhe subjektiv, dhe se nuk do të thotë të jetë i njëjtë me atë të bashkëjetuesit, si dhe kufizimi i një marrëdhënieje shoqërore brenda një marrëdhënie kontraktore me afat të caktuar, trupi gjykues i gjen alogjike. Qëndrimeve të subjektit të rivlerësimit iu mungon konsistenca dhe shpjegimet e dhëna duken si një përpjekje për të përjashtuar të dhënat mbi z. L. nga çdo ndikim që mund të kenë mbi procesin e saj të rivlerësimit.

25.9. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk duhet të kishte konkluduar që subjekti nuk ishte bindëse për mungesën e dijenisë, por duhet të kishte provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, dijeninë e subjektit të rivlerësimit/bashkëjetuesit për dënimin e z. L. përpara se të konkludonte për mosdeklarimin apo mosplotësimin me saktësi të deklaratës për kontrollin e figurës, trupi gjykues vlerëson se, nëse dijenia do të ishte provuar, atëherë kjo do të shërbente si shkak i pavarur shkarkimi nga detyra për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pika 2 ose pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në këtë drejtim, gjendet para një paqartësie si në vendimin objekt shqyrtimi, ashtu dhe në ankimin e subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, dhe se do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit. Nga interpretimi harmonik i parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në raport me ato të nenit 59, pikat 1 dhe 2 të po këtij ligji, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për kontrollin e figurës në ato raste kur ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 2, ka kontakte të papërshtatshme, ose neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës. Në rastin objekt shqyrtimi nuk duket se Komisioni ka konkluduar për një nga këto dy situata, por ka përdorur si bazueshmëri nenin 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që referon nenin 61, pika 5 e këtij ligji, për vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e të njëjtit ligj.

25.10. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues çmon që në fokus të vlerësimit të tij të mbeten qëndrimet kontradiktore të mbajtura nga subjekti i rivlerësimit mbi nivelin e njohjes së bashkëjetuesit me z. L. L. Aktet provuan që z. L. i shiti bashkëjetuesit të subjektit një mjet kamion me çmim më të ulët nga sa e kishte blerë dy javë më parë. Disa muaj më vonë, pas shitjes së këtij mjete, bashkëjetuesi i jep hua z. L. shumën 28.000 euro, me kontratë verbale dhe pa interes, e formalizuar më pas vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit, duke e shtyrë shlyerjen e saj për shkak të marrëdhënies së mirëbesimit (marrëdhënie e ngushtë familjare dhe miqësore). Këto fakte, në raport me qëndrimin shmangës dhe distant ndaj këtij personi, pas “Gjetjes dhe mendimit”, të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, duke e kufizuar njohjen e bashkëjetuesit me të që nga fëmijëria, në një shoqëri vetëm për periudhën 2016 – 2018, cenojnë besueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe afektojnë, për pasojë, perceptimin që publiku duhet të ketë në sistemin e drejtësisë, duke i vlerësuar ato në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

D. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

26. Në kuadër të këtij kriteri rivlerësimi, Komisioni ka konsideruar në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, masën disiplinore të dhënë nga KLGj-ja lidhur me videot e publikuara në rrjetin social “TikTok”, si dhe depozitim të deklaratave noteriale të denoncuesve, që deklaronin se denoncimi për subjektin e rivlerësimit nuk ishte bërë prej tyre.
27. *Lidhur me videot e publikuara në rrjetin social “TikTok”*, Komisioni në vendim vlerëson se subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim për të shmangur pasojat më të rënda në lidhje me procedurën disiplinore të ngritur ndaj saj, ka arritur një marrëveshje me KLGj-në. Në kërkesën e paraqitur në datën 30.09.2021, subjekti ka pranuar autorësinë e videove, të cilat janë regjistruar në telefonin e saj, por ka deklaruar se nuk ka pasur për qëllim që ato të përhapen për publikun e gjerë. Subjekti ka marrë përsipër peshën e përgjegjësisë së shkeljes së etikës të kryer, duke deklaruar se nuk është e nevojshme kryerja e ndonjë hetimi të hollësishëm, si ekspertimi telefonik, transkriptimi i tekstit të këngëve, verifikimi i kamerave të sigurisë, si dhe verifikimi i të dhënave profesionale. Në këtë kërkesë, ajo

shprehet: “Duke pranuar që në rastin konkret veprimet e mia cilësohen si shkelje e etikës”. Komisioni, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, ku ndër të tjera ajo vetë ka pranuar përmbajtjen e saj, dhe për rrjedhojë dhe se sjelljet e saj kanë cenuar besimin e publikut, si dhe duke marrë në konsideratë kryerjen e videove në ambientet e punës, shoqëruar me lëvizje e sjellje provokuese, në sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati, konstaton gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, i cili do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit.

Për sa i përket pretendimit për *gjë të gjykuar*, Komisioni, në vendimmarrjen e tij për subjektin e rivlerësimit, nuk është bazuar vetëm në këtë çështje, por në vlerësimin tërësor të procedurave. Komisioni ka marrë të mirëqenë konkluzionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), të cilat janë pranuar nga subjekti dhe, në këtë konkluzion, ka konsideruar se subjekti ka cenuar besimin e publikut. Sipas Komisionit, procesi i rivlerësimit rregullohet nga ligji nr. 84/2016, është një proces i pavarur dhe që nuk lidhet me veprimtarinë e organeve të tjera, për rrjedhojë, koncepti i *gjësë së gjykuar* nuk mund të gjejë aplikim në rastin në fjalë. Ndërsa në lidhje me periudhën e rivlerësimit, Komisioni vlerëson se, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, nuk ka asnjë dispozitë që të kufizojë procesin e rivlerësimit për sa i përket veprimeve të subjekteve, të cilat konsiderohen se kanë cenuar besimin e publikut.

28. Subjekti i rivlerësimit i kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se: (i) Ai ka paragjykuar veprimet e ndërmarra nga subjekti për arritjen e marrëveshjes me ILD-në, miratuar nga KLGj-ja, pa analizuar rezultatet e hetimit deri në çastin e arritjes së marrëveshjes, si dhe vendimmarrjet e mundshme në eventualitetin e ndjekjes së procedurës së zakonshme të procedimit disiplinor në rast mosarritje të marrëveshjes. Konkluzioni i Komisionit, se qëllimi i subjektit për të arritur këtë marrëveshje ka qenë shmangia nga ndonjë pasojë më e rëndë disiplinore, është i paprovuar dhe i pavërtetë. (ii) Komisioni ka rënduar padrejtësisht pozitën e subjektit në raport me vendimmarrjen përfundimtare të këtij procedimi disiplinor. Duke bërë një vlerësim të ndryshëm për të njëjtin fakt, ka cenuar parimet e “gjësë së gjykuar” dhe “sigurisë juridike”, si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Rivlerësimi i shkeljes disiplinore që ka zhbërë një vendim të një organi të përhershëm kushtetues si KLGj-ja, duke dhënë një vendim kontradiktor me të, cenon besimin ndaj Komisionit. (iii) Konkluzioni i Komisionit, se procesi i rivlerësimit është një proces i pavarur, që nuk lidhet me veprimtarinë e organeve të tjera, për rrjedhojë, koncepti “i gjësë së gjykuar” nuk mund të gjejë aplikim në rastin në fjalë, nuk qëndron. (iv) Gjetjet e Komisionit janë jashtë periudhës së rivlerësimit dhe organet kushtetuese që kanë juridiksion dhe kompetencë për t’i hetuar dhe marrë vendim, janë ILD-ja dhe KLGj-ja. Rivlerësimi i kësaj shkeljeje disiplinore nga Komisioni është tërësisht në shkelje të Kushtetutës dhe ligjeve nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016. (v) Konkluzioni se nuk ka asnjë dispozitë që të kufizojë procesin e rivlerësimit, lidhur me veprimet e subjekteve, që konsiderohen se kanë cenuar besimin e publikut, duke i dhënë vetes një pushtet të pakufizuar për ta interpretuar dhe zbatuar ligjin sipas dëshirës së tij, është i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe në prova deri në abuziv, pasi, në një interpretim të zgjeruar të ligjit, i jep vetes kompetenca të pakufizuara në drejtim të shtrirjes kohore lidhur me vlerësimin e aftësive etiko-profesionale të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, ndryshe nga qëndrimi për subjekte të tjerë rivlerësimi³⁹. (vi) Kolegji nuk duhet të marrë në shqyrtim këtë fakt, pasi nuk ka kompetencë ligjore dhe çështja është tashmë e gjykuar.

³⁹ Shih vendimin nr. 378, datë 30.04.2021, të Komisionit, dhe vendimin nr. 6/2020 (JR), paragrafi 47.1, të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Ç.

29. Trupi gjykues, në analizim të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë çështje, konstaton se:

29.1. Komisioni, nisur nga lajmi i bërë publik, në median e shkruar dhe atë publike, dhe rrjetet sociale, në datën 30.05.2021 dhe datën 31.05.2021 për disa video të publikuara në rrjetin social “TikTok”, në të cilat identifikohet subjekti i rivlerësimit, mbajti korrespondencë me KLGj⁴⁰-në, mbi praktikën e plotë dhe vendimmarrjen për pezullimin nga detyra të gjyqtarës Enkeleda Kapedani. Nga aktet e kësaj praktike, por edhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton si vijon:

29.1.1. ILD-ja, me vendimin nr. {***} prot., datë 31.05.2021, ka filluar me iniciativë hetimin disiplinor ndaj magjistrates Enkeleda Kapedani, ndërsa me vendimin nr. {***} prot., datë 01.06.2021, vendosi përfundimin e hetimit disiplinor dhe fillimin e procedimit disiplinor me propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 103, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 1 e ligjit nr. 96/2016. Në të njëjtën datë, ILD-ja, me shkresën nr. {***} prot., i kërkon KLGj-së fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Enkeleda Kapedani, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

29.1.2. Pas kërkesës së ILD-së, me vendimin nr. {***}, datë 07.06.2021, KLGj-ja vendosi pezullimin nga detyra të magjistrates Enkeleda Kapedani deri në përfundimin e procedimit disiplinor, si dhe vendosi t’i kërkojë ILD-së të kryejë hetime të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore të atribuuar magjistrates, znj. Kapedani. Këtë vendim të KLGj-së, subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar gjyqësisht, duke kërkuar shfuqizimin e tij, kërkesë e cila u rrëzua nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. {***}, datë 04.10.2021, si e pambështetur në ligj dhe prova.

29.1.3. Magjistratja Enkeleda Kapedani, më datë 30.09.2021, ka paraqitur para ILD-së, kërkesën për arritjen e marrëveshjes, bazuar në nenin 135 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë kërkesë, ajo shprehet se, nga momenti i publikimit të videove e në vijim, ka pasur një reflektim dhe qëndrim në lidhje me të gjithë situatën dhe vijueshmërinë e saj, duke vlerësuar të panevojshëm zhvillimin e hetimeve të mëtejshme.

29.1.4. Më datë 05.01.2022, pasi nënshkruhet “Marrëveshje e përbashkët pranimi”, mes ILD-së dhe gjyqtarës Enkeleda Kapedani, përmes së cilës palët bien dakord për caktimin ndaj magjistrates të masës disiplinore “Pezullim si masë disiplinore me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore 6 muaj”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “d” dhe neni 110 i ligjit nr. 96/2016, ILD-ja, me vendimin nr. {***} prot., datë 05.01.2022, vendosi: “Për përfundimin e hetimit disiplinor me marrëveshjen e përbashkët të pranimi me magjistratren Enkeleda Kapedani, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, për shkelje disiplinore, parashikuar nga neni 103, paragrafi 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016, si shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore, të miratuar nga KLGj-ja me vendimin nr. 171, datë 22.04.2022, seksioni “C”, “Parimi i integritetit”, shkronja “a” dhe “b”, seksioni “Ç”, “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbytje”, pika 9, shkronja “c”.

29.1.5. Me vendimin nr. {***}, datë 17.01.2022, “Për pranimin e përfundimit të hetimit disiplinor me marrëveshjen e përbashkët të pranimi, dakordësuar midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe

⁴⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.06.2021 dhe {***} prot., datë 22.09.2021, KLGj-ja përcjell praktikën e plotë lidhur me vendimmarrjen për pezullimin e gjyqtarës Enkeleda Kapedani, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga KLGj-ja.

magjistrates Enkeleda Kapedani, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, KLGj-ja vendosi: -- miratimin e marrëveshjes; -- ky vendim është i formës së prerë lidhur me procedimin disiplinor nr. {***}/2021, dhe si i tillë nuk mund të ankimohet.

29.2. Me rezultatet e hetimit administrativ, të datës 19.10.2021, përpara arritjes së marrëveshjes dhe miratimit të saj nga KLGj-ja, Komisioni konstaton se kryerja e disa veprimeve në ambiente të institucionit, në tejkalim të detyrës funksionale apo që nuk kanë lidhje me të, duket se prezanton papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit dhe cenon integritetin e magjistratit dhe, për rrjedhojë, edhe besimin e publikut. Subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur barrës së provës në tri drejtime: (i) lidhur me shtrirjen e periudhës objekt kontrolli; (ii) pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve kompetente; (iii) të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar si vijon:

29.2.1. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore⁴¹ përcaktojnë se periudha e rivlerësimit kalimtar për komponentin e vlerësimit profesional fillon prej datës 08.10.2013 deri më 08.10.2016, dhe si përjashtim periudhën nga 1 janari 2006 deri më datë 08.10.2016. Ky përcaktim është vendosur me qëllim respektimin e parimit të sigurisë juridike, nga njëra anë dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, nga ana tjetër, sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë⁴². Pas kësaj periudhe, në respektim të neneve 3, pika 2 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, të nenit 171 të ligjit nr. 96/2016, si dhe neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës, kompetencën ekskluzive për të bërë inspektimin e shkeljeve disiplinore dhe vlerësimin etik e profesional të magjistratëve e ka ILD-ja, KLGj-ja dhe KLP-ja⁴³, në të kundërt do të kishte përplasje kompetencash mes dy organeve kushtetuese dhe, për rrjedhojë, dy organe mund të merrnin vendime të njëjta apo/dhe të ndryshme për të njëjtin subjekt dhe për të njëjtin fakt.

29.2.2. Elementet e procesit të rregullt ligjor zbatohen edhe gjatë procedurave administrative. Një prej tyre është edhe parimi *ne bis in idem* apo mosgjyqimit/mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt. Në rastet kur shkelja e kryer kualifikohet si shkelje administrative, nuk mund të procedohet para dy organeve administrative në të njëjtën kohë, pasi në një rast të tillë ekziston mundësia e dhënies së vendimeve kontradiktore prej tyre, duke cenuar edhe parimin e sigurisë juridike. Ligji ka qenë i qartë në përcaktimin e kompetencave dhe ka ndarë periudhën e veprimtarisë së secilit prej organeve kushtetuese si: Komision, KLGj, KLP dhe ILD, në këtë drejtim.

29.2.3. Me qëllim përfundimin sa më shpejt të procedurës disiplinore dhe të shprehjes së ndjenjës së përgjegjësisë morale, subjekti ka shprehur dakordësinë për arritjen e marrëveshjes së pranimit, si një shenjë reflektimi, qytetarie, përgjegjësie, përgjegjshmërie dhe vetëndëshkimi moral. KLGj-ja ka vlerësuar se shkelja nuk e bën subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm ose të padenjë për të vijuar ushtrimin e funksionit dhe se masa e dakordësuar me ILD-në, ishte e përshtatshme. Sipas subjektit, çdo shkelje disiplinore e kryer nga një magjistrat passjell si pasojë cenimin e besimit të publikut te drejtësia dhe sjell në vëmendje raste të ndryshme procedimesh disiplinore, në të cilat KLGj-ja e ka konsideruar të kryer shkeljen nga magjistrati dhe se veprimet e tij kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut te drejtësia, duke caktuar sipas rastit masa të ndryshme disiplinore, “vërejtje

⁴¹ Neni E, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 40 - 41 të ligjit nr. 84/2016.

⁴² Shih vendimin nr. 11, datë 02.04.2008, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin shprehet se: “[...] Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007) ”.

⁴³ Shih vendimin nr. 378, datë 30.04.2021, të Komisionit dhe vendimin nr. 6 (JR), datë 18.06.2020, paragrafi 47.1., të Kolegjit.

publike”, “ulje page me 20%, për një periudhë 6-mujore” apo “shkarkim nga detyra”⁴⁴.

29.2.4. Ruajtja e besimit të publikut, në rastet e shkeljeve disiplinore të kryera nga magjistratët, sipas subjektit, është kompetencë e KLGj-së, e cila vlerëson rast pas rasti nëse pasoja e ardhur nga shkelja e kryer lejon vazhdimin e ushtrimit të funksionit nga magjistrati. Në rastin konkret, KLGj-ja ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit është e denjë dhe e përshtatshme për të vijuar detyrën e magjistrates, e për rrjedhojë, nuk ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë në atë masë, sa të sjellë përjashtimin e saj nga sistemi gjyqësor. Vendimi i KLGj-së është i formës së prerë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të shprehet më për të, përndryshe do të cenoheshin disa parime themelore të procesit të rregullt ligjor dhe vlerësimi i ndryshëm për të njëjtin fakt do të cenonte rëndë parimet e “gjësë së gjykuar”, “sigurisë juridike”, “mosndëshkimit dy herë për të njëjtën shkelje”, “ndarjes dhe balancimit të pushteteve”, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, në cenim të të drejtave kushtetuese të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

29.3. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se, referuar parashikimit në pikën 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Sa i përket periudhës kohore të rivlerësimit në kuadër të këtij kriteri, ligjvënësi është kujdesur të përcaktojë saktë shtrirjen e saj, nëpërmjet parashikimit në pikën 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, *sipas së cilit, vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale*. Referuar këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore arrihet në përfundimin se periudha 3-vjeçare lidhet me vlerësimin e aftësive profesionale sa u përket dosjeve të shortuara për këtë qëllim apo të përzgjedhura nga vetë subjekti, por vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet edhe përtej kësaj periudhe, që nga 2006 e në vazhdim, pa e kufizuar në kohë, në të njëjtën logjikë vjen më pas dhe parashikimi në pikën 1, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, që lidhet me denoncimet nga publiku. Si rrjedhojë, këto parashikime ligjore nuk kufizojnë burimet e vlerësimit vetëm në afatin 3-vjeçar, të përcaktuar në pikën 3, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, por nëse ka indicie apo të dhëna mbi fakte, të cilat afektojnë vlerësimin e institucioneve të rivlerësimit mbi tri kriteret, atëherë këto institucione kanë detyrimin ligjor për t’i marrë në shqyrtim dhe për t’i vlerësuar ato.

29.4. Megjithatë në rastin objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk ka cenuar juridiksionin e organit kushtetues kompetent apo parimet themelore të procesit të rregullt ligjor, pasi rrethanat e konstatuara në vendimin e ILD-së/KLGj-së nuk i kanë shërbyer Komisionit si shkak përcaktues më vete në drejtim të marrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por janë përfshirë në vlerësimin tërësor të çështjes. Me konsideratë diskrecionin e organeve të reja të drejtësisë, ILD/KLGj, vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre mbi procedimin disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në kushtet kur rrethanat e konstatuara nga këndvështrimi i një vëzhguesi të arsyeshëm ndikojnë negativisht në perceptimin e publikut, vlerëson se vendimmarrjet e këtyre organeve nuk mund të mbeten jashtë procesit të rivlerësimit dhe të mos konsiderohen si burime vlerësimi sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në një proces, që qëllimin kryesor të tij ka pikërisht rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Për sa më sipër, vendimin nr. {***}, datë 17.01.2022 të KLGj-së, me të cilin është vendosur miratimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit, trupi gjykues vendosi ta mbajë në konsideratë në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, pa analizuar në thelb shkeljet disiplinore të trajtuara në të.

⁴⁴ Për procedimet disiplinore, respektivisht të magjistratëve, H. S./P. F./M. K.

30. Në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur në konsideratë rrethanat si: (i) qëndrimet kontradiktore të mbajtura nga subjekti i rivlerësimit, mbi nivelin e njohjes së bashkëjetuesit me z. L. L., në kuadër të marrëdhënieve kontraktore mes tyre, në raport me qëndrimin shmangës dhe distant ndaj këtij personi, duke e kufizuar njohjen që nga fëmijëria në një shoqëri vetëm për periudhën 2016 – 2018, pas “Gjetjes dhe mendimit” të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, dhe (ii) vendimin nr. {***}, datë 17.01.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me të cilin është vendosur “Miratimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimi, dakordësuar midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates Enkeleda Kapedani, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lidhur me procedimin disiplinor nr. {***}/2021”, pa i hyrë vlerësimit të shkeljeve disiplinore objekt të këtij procedimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Kolegji, në kushtet kur vlerësoi të mjaftueshme konstatimet më sipër, për të bërë të zbatueshëm këtë dispozitë ligjore, çmoi pa ndikim në vendimmarrjen e tij, analizimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me konkluzionin e Komisionit mbi depozitimin e deklaratave noteriale të denoncuesve.
31. Duke e konsideruar të mjaftueshëm arsyetimin në këtë vendim, për të arritur në vlerësimin përfundimtar dhe vendosjen e masës disiplinore “të shkarkimit nga detyra” për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues çmoi të panevojshëm analizimin e shkaqeve të tjera të ankimit të paraqitura në Kolegji, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të përmbyste vlerësimin përfundimtar të tij, lidhur me këtë çështje.
32. Në përfundim, trupi gjykues në Kolegji, mbështetur në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, e për pasojë, çmon se vendimi nr. 533, datë 18.05.2022, i Komisionit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 533, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 11.03.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes nr. 40/2022 (JR), kam mbajtur qëndrim kundër shumicës së trupit gjykues, lidhur me vendimin nr. 19, datë 11.03.2025, që i përket subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, çështje e cila u gjykua në Kolegj, mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit, kundër vendimit nr. 533, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Vendimmarrjen për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si nga Komisioni, ashtu edhe nga shumica e trupit gjykues në Kolegj, e vlerësoj të padrejtë dhe në mungesë të një analize të plotë të rrethanave faktike dhe ligjore të çështjes, pasi ka të bëjë me veprime juridike, që bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, L. Q., ka ndërmarrë me persona të tretë, mbi shitjen dhe blerjen e një automjeti kamion tip “Iveco Magirus”, prodhim i vitit 2004, marrëdhënies së tij me shitësin e automjetit, pa evidentuar përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në këto veprime. Shumica e trupit gjykues ka dështuar në marrjen në analizë të kohës kur janë kryer këto veprime, përfitimet e mundshme të subjektit të rivlerësimit dhe ndikimin e tyre në pasurinë, integritetin dhe profesionalizmin e saj, në kuadër të këtij procesi.

A. Lidhur me periudhën kohore të ushtrimit të detyrës së gjyqtares

3. Pikësëpari, sjell në vëmendje se subjekti i rivlerësimit, me dekretin nr. {***}, datë 21.10.2013, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është caktuar të kryejë stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka zgjatur deri në muajin korrik të vitit 2014, kohë kur subjekti ka marrë statusin e gjyqtares. Nga muaji korrik i vitit 2014 deri në muajin shtator të vitit 2015, rreth një vit e dy muaj, subjekti i rivlerësimit ka qenë në pritje të emërimit përfundimtar, duke mos ushtruar efektivisht detyrën e gjyqtares, edhe pse rezultonte pjesë e organikës së Gjykatës të Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Me dekretin nr. {***}, datë 25.09.2015, të Presidentit, subjekti i rivlerësimit emërohet përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit në detyrën e gjyqtare, për 9 (nëntë) muaj në total.

3.1. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, është lehtësisht e provueshme se, deri në datën e blerjes së kamionit nga bashkëjetuesi, me kontratën e blerjes nr. {***}/{***} rep./kol., datë 29.04.2016, subjekti i rivlerësimit kishte ushtruar detyrën si gjyqtare vetëm 3 (tre) muaj, konkretisht, tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2015, dhe ndodhej me raport mjekësor të lejes së lindjes.

3.2. Rezultoi i provuar, si në Komision ashtu edhe në Kolegj, burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie, në muajin prill 2016, me të ardhura të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, nga shitja e pasurisë “tokë arë”, me kontratë noteriale shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2011, për të cilën Komisioni dhe Kolegji nuk kanë konstatuar problematika.

3.3. Sa i përket veprimeve juridike të kryera nga bashkëjetuesi i subjektit lidhur me këtë automjet, në kushtet kur rezultoi e provuar ligjshmëria e burimit të krijimit dhe kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit deri në kryerjen e tyre, në cilësinë e gjyqtares në pakicë, çmoj se shumica e trupit gjykues duhet të kishte mbajtur në konsideratë këto rrethana të rëndësishme dhe të vlerësonte çështjen e udhëhequr nga parimi i objektivitetit.

B. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

4. Lidhur me vendimin e Komisionit, lënë në fuqi nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, konstatoj dhe vlerësoj se:

4.1. Referuar përmbajtjes së vendimit nr. 533, datë 18.05.2022, të Komisionit, dhe vendimit nr. 19, datë 11.03.2025, të Kolegjit, *dy vendime jounanime* në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, është analizuar në tërësi situata e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit në raport/marrëdhënie me të tretë. Në tërësi, përmbajtja e këtyre vendimmarrjeve fokusohet kryesisht në veprimet e blerjes dhe shitjes të kryera nga bashkëjetuesi i subjektit, mbi automjetin kamion tip “Iveco Magirus”, dhe huan e dhënë prej tij me të ardhura nga shitja e këtij automjeti. Si gjyqtare në pakicë, e gjej tërësisht të pabazuar dhe alogjik, ngarkimin me përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit në kuadër të vlerësimit të pasurisë, duke e klasifikuar subjektin në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk ekziston asnjë mungesë burimesh financiare për pasuri/shpenzim/kursim në emër të saj.

4.2. Në vlerësimin tim, çmimi i blerjes së automjetit i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së datës 29.04.2016, mes bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit dhe shitësit, shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerën 950.000 lekë, nuk lë vend për dyshim. Këtë bindje ma krijon çmimi i transaksionit pararendës të blerjes, më datë 13.04.2016, me të cilin kjo shoqëri e ka përfituar automjetin, në vlerën 1.100.000 lekë. Diferenca prej 150.000 lekësh konsiderohet e papërfillshme për kushtet e tregut të lirë dhe e pamjaftueshme për të ngritur dyshime mbi fiktivitetin veprimesh juridiko-financiare⁴⁵. Nga ana tjetër, ky zinxhir veprimesh të njëpasnjëshme nga blerja e automjetit në shtetin italian dhe shitja e tij në 3 (tre) transaksionet vijuese, tregon se automjeti është blerë me çmim të ulët dhe shitësit pararendës nuk kanë pësuar asnjë humbje. Përpos kësaj, sikurse arsyetuar edhe më lart, nga analiza financiare e Komisionit, e konfirmuar në Kolegji, u provua tërësisht mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhënë bashkëjetuesit të saj, për blerjen e këtij automjeti.

4.3. Konkluzionet e vendimeve të mësipërme, për kryerjen e veprimeve fiktive nga bashkëjetuesi i subjektit, për mua si gjyqtare në pakicë nuk qëndrojnë, pasi si subjekti, ashtu edhe bashkëjetuesi, nuk kanë krijuar asnjë pasuri, nuk kanë mbuluar asnjë shpenzim, si dhe nuk kanë shlyer asnjë detyrim, me të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, në vlerën 32.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. {***}/ {***} rep./kol., datë 13.10.2016, fakt i provuar nga hetimi i të gjitha deklaratave periodike vjetore të periudhës 2016 – 2021, të dorëzuara nga subjekti në vijueshmëri gjatë hetimit administrativ. Në vlerësimin tim, nuk mund të konsiderohen veprime fiktive, ato të cilat kryhen para nëpunësit publik, nëpërmjet kontratave noteriale, dhe mbi të gjitha kur nuk provohet vullneti i vërtetë i palëve kontraktore, i fshehur pas këtyre veprimeve. Fiktiviteti i konstatuar nga shumica e trupit gjykues në Kolegji, në vlerësimin tim, është pasojë e një arsyetimi deduktues të shumicës, i pambështetur në provat e administruara për këtë çështje.

⁴⁵ Nga aktet në dosjen gjyqësore, rezulton se automjeti kamion është importuar nga Italia, më 04.02.2016, nga shoqëria “{***}” ShPK, blerë 6.000 euro (konvertuar në 823.680 lekë), për të cilin është shlyer tarifa doganore në vlerën 177.364 lekë. Pra, në total nga ana e blerësit, shoqëria “{***}” ShPK është paguar shuma 1.064.193 lekë, e që më pas i është shitur shoqërisë “{***}” ShPK, me faturë TVSh-je, me çmim 1.100.000 lekë. Në këto kushte, shoqëria “{***}” ShPK, nuk ka pësuar asnjë humbje nga shitja e automjetit me këtë çmim, përkundrazi ka fituar 35.807 lekë. Duke qenë se automjeti është blerë nga shoqëria “{***}” ShPK me faturë TVSh-je, atëherë prej tij është paguar vetëm 916.667 lekë, ndërsa vlera prej 183.333 lekë është TVSh e rimbursueshme te pala blerëse. Me anë të kontratës së shitjes së datës 29.04.2016, shitësi, shoqëria “{***}” ShPK, e shet te blerësi L. Q. automjetin, në çmimin 950.000 lekë. Duke qenë se shitësi pararendës “{***}” ShPK kishte paguar për blerjen e tij vetëm 916.667 lekë dhe e ka shitur atë 950.000 lekë (te bashkëjetuesi i subjektit), do të thotë se nuk ka pësuar asnjë humbje ekonomike, përkundrazi ka fituar një shumë prej 33.333 lekë, e cila shmanget dyshimet për fiktivitetin për çmimin e ulët të blerjes së automjetit.

- 4.4. Konsiderimi në analizë financiare i të ardhurës nga shitja në të njëjtën vlerë me atë të blerjes, pra 950.000 lekë, ndërkohë që kontrata e shitjes pasqyron vullnetin e palëve kontraktore në përcaktimin e çmimit 32.000 euro, e kanë çuar subjektin e rivlerësimit/bashkëjetuesin në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 3.219.154 lekë, për dhënien e huas në shumën 28.000 euro, në vitin 2016. Ky vlerësimi i gabuar i Komisionit, i konfirmuar më pas dhe nga shumica e trupit gjykues, vjen në kundërshtim me të dhënat e ekstraktuara nga aktet shkresore [kontratat noteriale me fuqinë e ligjit], të administruara në cilësinë e provës në fashikullin gjyqësor të Komisionit, të pakontestuar për falsitet.
- 4.5. Në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani duket që Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë periudhën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë, të urdhëruar nga ligji i këtij procesi, duke shkuar përtej qëllimit të tij, nëpërmjet hetimit edhe të pasurive të vëna pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, konkretisht të automjetit tip “Volkswagen”, blerë në shkurt të vitit 2017, në shumën 360.000 lekë, si dhe apartamentit të banimit në vitin 2019, në bashkëpronësi me bashkëjetuesin, financuar 100% me kredi bankare. Pra, përsëri Komisioni nuk evidentoi përfshirjen e të ardhurave nga shitja e këtij automjeti, në tetor 2016, apo kthimin e huas në vitet 2017 dhe 2018, për krijimin e këtyre pasurive.
- 4.6. Çmimi i shitjes prej 32.000 eurosh, nga bashkëjetuesi, më 13.10.2016, i korrespondon vlerës reale të automjetit, pasi ky automjet është rishitur më pas me çmimin 30.000 euro, nga z. A. V., si dhe aktet provuese në dosjen gjyqësore, kontratat e ngjashme dhe informacioni nga burime të hapura, mbështesin pretendimet e subjektit të rivlerësimit se çmimi i blerjes së kamionit në vlerën 950.000 lekë, nga bashkëjetuesi në prill 2016, ka qenë *okazion*.
- 4.7. Arsyetimin e tejzgjatur dhe të panevojshëm të shumicës së trupit gjykues në vendim (paragrafët 16.10 dhe 16.12), në drejtim të verifikimit të situatës financiare të shitësit të automjetit, shtetasit L. L. e vlerësoj joproduktiv dhe aspak në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, që ka për qëllim verifikimin e saktësisë, mjaftueshmërisë dhe ligjshmërisë së pasurisë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në deklaratën e pasurisë *vetting*.
5. Sa më sipër: (i) duke vlerësuar faktin se subjekti i rivlerësimit e ka ushtruar detyrën vetëm 3 (tre) muaj në kohën që bashkëjetuesi i saj ka bërë blerjen e automjetit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit për një periudhë 9 (nëntë) - muajore në total; (ii) fakti që subjekti nuk ka qenë ndonjëherë e dyshuar për abuzim me detyrën; (iii) fakti që subjekti me të ardhurat nga shitja e automjetit kamion nuk ka shtuar asnjë pasuri, nuk ka shlyer asnjë detyrim ndaj të tretëve; (iv) nuk ka marrë pjesë/nënshkruar/dhënë pëlqim, në asnjë veprim juridik të kryer nga bashkëjetuesi; (v) ka qenë konsekuente në deklaratimet e saj për pasuritë dhe për burimin e krijimit të tyre; (vi) nuk ka vepruar në keqbesim dhe as ka kryer ndonjë shkelje ligjore, e mbi të gjitha rezultoi me bilanc pozitiv për shumën që i ka dhënë bashkëjetuesit për blerjen e automjetit kamion, më çojnë drejt konkluzionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në kuadër të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe masa disiplinore e shkarkimit të saj nga detyra, nuk është aspak objektive.
6. Nën dritën e parimit të objektivitetit çmoj se shumica e trupit gjykues nuk ka vlerësuar drejt rrethanat e cituara në paragrafin më sipër dhe në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, e me vetë qëllimin e procesit të rivlerësimit, e ka ngarkuar subjektin e rivlerësimit Enkeleda Kapedani me përgjegjësi për veprime të kryera nga bashkëjetuesi i saj dhe shtetasi L. L., edhe pse ky i fundit nuk është subjekt i këtij ligji.

7. Në cilësinë e gjyqtarës në pakicë, kundërshtoj konkluzionet e arritura si nga Komisioni, ashtu edhe nga Kolegji në vendimet përkatëse për këtë kriter:

7.1. Përfundimin e Komisionit, se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin kontrollit të figurës, sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, dhe se do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj saj; dhe konkluzionin e shumicës së trupit gjykues në Kolegj, se: “[...] në fokus të vlerësimit të tij të mbeten qëndrimet kontradiktore të mbajtura nga subjekti i rivlerësimit mbi nivelin e njohjes së bashkëjetuesit me z. L. L. [...] cenojnë besueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe afektojnë, për pasojë, perceptimin që publiku duhet të ketë në sistemin e drejtësisë, duke i vlerësuar ato në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016” -- i vlerësoj të padrejta dhe të pabazuara në prova dhe ligj.

7.2. Lidhur me “Gjetjen dhe mendimin” e ONM-së, gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për konstatimin se: “Personi i lidhur, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, ka pasur kontakt te papërshtatshëm me shtetasin L. L., në shkelje të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016; Subjekti i rivlerësimit nuk kishte përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar kontaktin e papërshtatshëm të personit të lidhur/bashkëjetuesit të saj me shtetasin L. L., përcaktuar në deklaratën për kontrollin e figurës në germenat “d” dhe “f”, në pjesën 5, të titulluar “Të dhënat për sigurinë, për shkak të hyrjes në marrëdhënie kontraktore shitblerje dhe huadhënie/interesa pasurorë, të bashkëjetuesit me këtë shtetas”.

7.3. Për mua, gjyqtare në pakicë, duke e konsideruar të rëndësishme analizën e këtij kriteri, në kuadër të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, çmoj se si nga Komisioni, ashtu dhe nga Kolegji, në asnjë rast nuk u provua që bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit kishte dijeni lidhur me veprimtarinë e kryer nga shtetasi L. L., në shtetin italian, aq më tepër subjekti i rivlerësimit. Dyshimet për këtë kriter kurrsesi nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit (*in dubio pro reo*). Subjekti i rivlerësimit Enkeleda Kapedani ka dhënë përpara Komisionit shpjegime të mbështetura në prova, të cilat, në vlerësimin tim, nuk mund të cilësohen si kontradiktore.

7.4. Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se:

7.4.1. Z. L. L., sipas vërtetimit nr. {***}, datë 11.03.2022, lëshuar nga Njësia Administrative {***}, Tiranë, është larguar nga vendlindja e tij në vitin 2003.

7.4.2. Gjatë gjykimit, nuk është provuar që bashkëjetuesi të ketë pasur ndonjë raport me këtë shtetas, që nga koha e largimit nga vendbanimi, në vitin 2003, deri në çastin e arrestimit të tij, në vitin 2004, në shtetin italian, e aq më pak nga viti 2004 deri në kohën e kryerjes së veprimeve juridike, në vitin 2016, pra 12 vite më pas.

7.4.3. Ka rezultuar e provuar se bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit dhe shtetasi L. L. kanë lindur në të njëjtin fshat {***}, Tiranë dhe është pranuar që njihen që në fëmijëri si bashkëvendas. Ky fakt, jo domosdoshmërisht nënkupton se ata kanë dijeni për rrethana specifike të jetës së secilit prej tyre.

7.4.4. Bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka pranuar nëpërmjet deklaratës noteriale të administruar në dosje se nuk ka pasur ndonjëherë marrëdhënie të afërta me këtë shtetas deri në vitin 2016, vit kur u futën në marrëdhënie juridike mes tyre, marrëdhënie e cila u zbeh derisa u prish në vitin 2018, kur përfundoi edhe marrëdhënia e huas.

7.4.5. Fakti që për këtë shtetas nuk është bërë asnjë kërkesë për njohje vendimi penal të huaj apo ekstradim, provuar kjo edhe me shkresën nr. {***}, datë 29.04.2022, të Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën thuhet se nuk ka asnjë vendim penal të huaj të njohur për këtë shtetas, nga autoritetet shqiptare.

7.4.6. Me dëshminë e penaltetit nr. {***}, datë 17.03.2022, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, shtetasi L. L. rezulton i padënuar për institucionet e vendit tonë.

7.4.7. Mjetet e informimit masiv (media e shkruar dhe vizive), nuk e kanë pasqyruar këtë fakt në internet, pra ka pamundësi për t'u njohur me këtë informacion nga burime të hapura.

7.4.8. Nuk ka asnjë njoftim mediatik apo rrethanë tjetër, të cilat t'i jepnin indikacione subjektit apo bashkëjetuesit të saj se ky shtetas ishte dënuar në një shtet të huaj. Siç rezulton edhe nga dokumentet e administruara nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ky shtetas ka qenë me masë sigurimi "Periudhë prove për 3 vite", pra nuk ka qenë i arrestuar dhe nuk ka munguar fizikisht në Shqipëri, në mënyrë që dikujt t'i bënte përshtypje mungesa e tij fizike e të prezumonte se mund t'i kishte ndodhur diçka jashtë shtetit.

7.4.9. Sipas sistemit TIMS, rezulton se L. L. ka disa hyrje-dalje në/nga Republika e Shqipërisë në vitin 2004, në vitet 2005, 2006, 2007, si dhe nuk rezulton të ketë datë dalje nga Republika e Shqipërisë në vitin 2012, kur është dënuar me vendim të formës së prerë, fakt që tregon se ai nuk e ka vuajtur asnjëherë këtë dënim. Fakti që ky shtetas lëvizte vazhdimisht jashtë vendit, shmang dyshimin se mund të kishte problem ligjor në ndonjë vend të huaj.

7.5. Shumica e trupit gjykues, në paragrafin 25.9 të vendimit, ka konkluduar se: *Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk duhet të kishte konkluduar që subjekti nuk ishte bindëse për mungesën e dijenisë, por duhet të kishte provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, dijeninë e subjektit të rivlerësimit/bashkëjetuesit për dënimin e z. L., përpara se të konkludonte për mosdeklarimin apo mosplotësimin me saktësi të deklaratës për kontrollin e figurës, trupi gjykues vlerëson se, nëse dijenia do të ishte provuar, atëherë kjo do të shërbente si shkak i pavarur shkarkimi nga detyra për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pika 2 ose pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në këtë drejtim, gjendet para një paqartësie në vendimin objekt shqyrtimi, ashtu dhe në ankimin e subjektit të rivlerësimit [...].* Atëherë pse në rrethana të paqartësisë, ky moment kaq i rëndësishëm për besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit, është parë nga shumica e trupit gjykues, në vlerësimin tërësor të çështjes, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në këtë rast, shumica e trupit gjykues duhet të kishte provuar nëse subjekti i rivlerësimit ose bashkëjetuesi i saj kishin dijeni për dënimin e tij, në shtetin italian, argumentet e renditura më sipër janë bindëse, përderisa shumica nuk provoi të kundërtën.

7.6. Lidhur me dijeninë e vetë subjektit të rivlerësimit, nga hetimi administrativ konstatoj se: (i) nuk u provua në asnjë rast që subjekti kishte lidhje familjare me këtë shtetas; (ii) nuk del nga të dhënat e sistemit TIMS që subjekti dhe bashkëjetuesi i saj të kenë udhëtuar me të; (iii) nuk rezulton që subjekti të ketë gjykuar këtë shtetas apo familjarë të tij etj.

Pra, si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk u provua që subjekti të kishte lidhje/njohje me këtë shtetas, e mbi të gjitha të ishte në dijeni të faktit të dënimit të tij në Itali. Kjo e përforcon faktin se, nëse subjekti i rivlerësimit do të ishte në dijeni, kurrësi nuk do të kishte paraqitur deklaratën noteriale nr. {***}/{***} rep./kol., datë 24.07.2018, të shtetasis L. L. dhe bashkëjetuesit, në përgjigje të pyetësorëve për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), si institucioni kompetent për verifikimin e pastërtisë së figurës së subjektit, nuk ka konstatuar përfshirjen e saj ose të bashkëjetuesit në aktivitet kriminal apo kontakte të papërshtatshme. Asnjë nga organet ligjzbatuese nuk kanë informuar subjektin për aktivitetin kriminal të shtetasit L. L. në shtetin italian, madje dukshëm këto institucione nuk kanë pasur dijeni për veprimtarinë kriminale të tij, duke qenë se raporti i DSIK-së, pas kryqëzimit të informacionit që dispononin të gjitha institucionet e mësipërme, e kanë konsideruar subjektin të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës në raportin e parë dhe në atë të përditësuar, nuk kanë konstatuar asnjë kontakt të papërshtatshëm mes saj apo personave të lidhur me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

7.7. Në referencë të të gjitha rrethanave të mësipërme, dukshëm, bashkëjetuesi i subjektit nuk ka qenë në dijeni të dënimit të këtij shtetasi në Itali dhe nuk mund të prezumohet dijenia e tij, e aq më pak të prezumohet dijenia e subjektit të rivlerësimit.

D. Për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit

8. Shumica e trupit gjykues nuk është ndalur në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtare relatore të çështjes, në të njëjtën kohë dhe gjyqtare në pakicë, vërej se në të gjitha elementet e analizuara në kuadër të këtij kriteri nuk është konstatuar asnjë shkelje ligjore për subjektin e rivlerësimit Enkeleda Kapedani. Vendimet gjyqësore pa përjashtim, objekt kontrolli në kuadër të këtij kriteri, kanë qenë të dhëna brenda afatit ligjor, si dhe në përputhje me ligjin, kjo e konfirmuar edhe nga Komisioni. Në këtë rast vlen të theksoj se:

8.1. Për të tria dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se vendimet e dhëna prej saj paraqiten të standardizuara në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

8.2. Për 5 (pesë) dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit respekton afatin kohor në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, dhe vendimet gjyqësore rezultojnë të jenë arsyetuar mjaftueshëm. Në drejtim të ecurisë gjyqësore të vendimeve në pesë çështjet e shortuara, katër prej këtyre vendimeve nuk rezultojnë të jenë ankimuar dhe një vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

8.3. Në tërësi të verifikimit të këtyre çështjeve, Komisioni, ashtu siç shprehet në vendim, nuk ka konstatuar parregullsi të natyrës procedurale dhe nuk ka identifikuar asnjë problematikë në drejtim të njohurive ligjore, të arsytimit ligjor, njohurive organizative, si dhe në kriteret e tjerë matës të vlerësimit të etikës në punë, integritetit, komunikimit dhe paanësisë në gjykime, në përputhje të plotë të indikatorëve profesionalë të parashikuar nga ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 72, 74 dhe vijues.

8.4. Lidhur me çështjet e tjera, të trajtuara në kuadër të indicieve të marra nga autoritetet verifikuese, si për çështjen civile, ashtu edhe për çështjet penale, Komisioni nuk konstatoi problematika të cilat mund të ndikonin në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit apo penalizimin e saj në kuadër të këtij kriteri.

8.5. Për çështjet e denoncuara, ndonëse Komisioni është kujdesur t’i hetojë dhe t’i trajtojë gjerësisht në vendimin objekt shqyrtimi, në përfundim nuk ka identifikuar shkelje/problematikë, që cenon apo ndikon në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Fakt ky që tregon se subjekti i rivlerësimit Enkeleda Kapedani, në kuadër të këtij kriteri, ka arritur një nivel kualifikues të konsiderueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

- 8.6. Shumica e trupit gjykues nuk u ndal as në rezultatet e larta të arritura nga subjekti i rivlerësimit gjatë studimeve të saj, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe në Shkollën e Magjistraturës⁴⁶.
9. Në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 17.01.2022, të KLGj-së, për videot e publikuara në rrjetin social “TikTok”, të cilin shumica e ka trajtuar në vlerësimin tërësor të çështjes parashikuar nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndaj qëndrim tërësisht të kundërt. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, si Komisioni, ashtu edhe shumica e trupit gjykues kanë cenuar parimin *bis in idem*, apo mosgjykimin/mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt, në kushtet kur për këto video, ndaj subjektit të rivlerësimit ishte zbatuar më herët masa disiplinore “*Pezullim si masë disiplinore me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore 6 muaj*”, miratuar me vendimin nr. {***}, datë 17.01.2022, të KLGj-së, aq më tepër të renditet në vlerësimin tërësor të çështjes sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi kjo dispozitë ka të bëjë vetëm për çështjet që janë hetuar e gjykuar gjatë procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
10. Si gjyqtare në pakicë vlerësoj se shumica e trupit gjykues të Kolegjit duhet të kishte analizuar siç duhet situatën faktike dhe ligjore lidhur me vetë subjektin e rivlerësimit, për të cilën, në vlerësimin tim, sa arsyetuar më sipër, nuk rezultuan probleme për të tria kriteret e rivlerësimit, sipas ligjit. Të dhënat mbi situatën financiare dhe gjendjen gjyqësore të z. L. L., nuk mund të afektojnë procesin e rivlerësimit ndaj subjektit, në drejtim të saktësisë dhe të mjaftueshmërisë në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollin e figurës, në këtë rast. Elementet e përfshira nga shumica e trupit gjykues në Kolegji, në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, i vlerësoj pa peshë dhe jopërcaktuese në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, për çështjen objekt shqyrtimi, unë, gjyqtare në pakicë, vlerësoj se Kolegji duhet të dispononte me ndryshimin e vendimit nr. 533, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Kapedani.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

⁴⁶ Studimet për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, i ka përfunduar me mesatare 9.8, studimet master me mesatare 9.85, dhe është renditur e dyta në përfundim të studimeve në Shkollën e Magjistraturës.